

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

2025

Nr. Rendor ¹	Data e kërkesës ²	Objekti i kërkesës ³	Data e përgjigjes ⁴	Përgjigje ⁵	Mënyra e përfundimit të kërkesës ⁶	Tarifa ⁷
1.	23.12.2024	Përsëritje. Pranë Inspektoratit Qendror është administruar në formë elektronike kërkesa për informacion, drejtor ekzekutiv i organizatës jofitimprurëse Qendra “Centre for Legal Empowerment”, përmes së cilës kërkon informacion, si vijon: A janë kryer inspektime në fshatin Bërdicë (përfshirë dhe zonën e mbrojtur)? Nëse po, të vihen në dispozicion kopje të	07.01.2025	Përsëritje, Në vijim të informacionit të dërguar në lidhje me inspektimet në fshatin Bërdicë përfshirë dhe zonën e mbrojtur nga institucioni i IKMT-së informojmë si më poshtë: Duke u mbështetur në informacionet e marra nga Drejtoria e Mjedisit dhe Ujrave në Drejtorinë Qendrore, si dhe verifikimin e bërë nga Drejtoria Rajonale Shkodër, nuk rezulton që të jetë kryer inspektim në zonën e Bërdicës.	E plote	Nuk ka

		raporteve për inspektimet e kryera. A është konstatuar nëse ushtrohet veprimtari minerare me karrierë (gurore) në fshatin Bërdicë (në zonën e mbrojtur dhe jashtë saj)? A janë konstatuar shkelje të kuadrit ligjor në fuqi nga subjektet që ushtrojnë veprimtari minerare me karrierë (gurore) në fshatin Bërdicë? Nëse po, çfarë masash janë marrë, si dhe të vendosen në dispozicion kopje të masave të marra. Sa më sipër, në zbatim të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, I		Gjithashtu ju njoftojmë se në këtë zonë nuk rezulton të ketë veprimtari minerare me karrierë (gurore). Ju falenderojmë për mirëkuptimin		
--	--	---	--	---	--	--

2	08.01.2025	Drejtuar: Inspektoriatit Vendor të Mbrojtjes së Territorit Tiranë Për dijeni: Inspektoriatit Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit Përshëndetje, Duke u mbështetur në Ligjin Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe në përputhje me nenet e këtij ligji, i cili rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike, ju drejtojmë me këtë kërkesë për të marrë informacionin e mëposhtëm: 1. Sa herë është gjobitur nga institucioni juaj shtetasi, banues i mëparshëm në Shkozë 2. Cilat kanë qenë shkeljet përkatëse nga ana e z. Feim	09.01.2025	Përshëndetje, Drejtuar: Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë Në adresën e-mailit të koordinatorit të të drejtës për informim, IKMT, është paraqitur për dijeni kërkesa nga, për informacion mbështetur në Ligjin nr. 119/2014, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”. Bashkëlidhur po Ju përcjellim për kompetencë kërkesën sipas ligjit të sipërcituar paraqitur nga ...për verifikim dhe trajtim nga ana Juaj. Faleminderit për bashkëpunimin!	E deleguar	Nuk ka
---	------------	---	------------	---	------------	--------

		Selam Çollaku, duke vendosur në dispozicion kopjet e vendimeve? 3. A i ka shlyer ai detyrimet dhe nëse jo, sa është vlera e gjobave sot, duke llogaritur dhe kamatëvonesat? Bazuar në detyrimet ligjore për transparencë dhe në të drejtën e qytetarëve për t'u informuar, presim që të na mundësoni informacionin e kërkuar brenda afatit të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi. Duke ju falënderuar paraprakisht për bashkëpunimin, mbetemi në pritje të një përgjigjeje sa më të shpejtë nga ana juaj. Me respekt,				
--	--	--	--	--	--	--

3	11.02.2025	Në kuadër të transparencës publike, duke u bazuar tek ligji nr. 119/2014, "Për të Drejtën e Informimit" i ndryshuar, ju kërkojmë: 1. Listën e plotë të subjekteve ndaj të cilave janë marra masa administrative nga Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit në vitin 2018. 2. Listën e plotë të subjekteve ndaj të cilave janë marra masa administrative nga Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit në vitin 2019.	20.02.2025	I nderuar Në vijim të kërkesës suaj për informacion me Nr. 3 Rendro, datë 11.02.2025, po ju përcjellim të dhënat e kërkuara në lidhje me masat administrative të vendosura nga Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT) gjatë periudhës 2018-2024, si më poshtë: <table><tr><td>Viti 2018</td><td>110 masa administrative (gjoba)</td></tr><tr><td>Viti 2019</td><td>275 masa administrative (gjoba)</td></tr></table>	Viti 2018	110 masa administrative (gjoba)	Viti 2019	275 masa administrative (gjoba)	E plote	Nuk ka
Viti 2018	110 masa administrative (gjoba)									
Viti 2019	275 masa administrative (gjoba)									

	3. Listën e plotë të subjekteve ndaj të cilave janë marra masa administrative nga Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit në vitin 2020. 4. Listën e plotë të subjekteve ndaj të cilave janë marra masa administrative nga Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit në vitin 2021. 5. Listën e plotë të subjekteve ndaj të cilave janë marra masa administrative nga Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit në vitin 2022.		<table><tr><td>Viti 2020</td><td>223</td></tr><tr><td></td><td>masa administrative (gjoba)</td></tr><tr><td>Viti 2021</td><td>161</td></tr><tr><td></td><td>masa administrative (gjoba)</td></tr><tr><td>Viti 2022</td><td>308</td></tr><tr><td></td><td>masa administrative (gjoba)</td></tr><tr><td>Viti 2023</td><td>307</td></tr><tr><td></td><td>masa administrative (gjoba)</td></tr><tr><td>Viti 2024</td><td>447</td></tr><tr><td></td><td>masa administrative (gjoba)</td></tr></table>	Viti 2020	223		masa administrative (gjoba)	Viti 2021	161		masa administrative (gjoba)	Viti 2022	308		masa administrative (gjoba)	Viti 2023	307		masa administrative (gjoba)	Viti 2024	447		masa administrative (gjoba)		
Viti 2020	223																								
	masa administrative (gjoba)																								
Viti 2021	161																								
	masa administrative (gjoba)																								
Viti 2022	308																								
	masa administrative (gjoba)																								
Viti 2023	307																								
	masa administrative (gjoba)																								
Viti 2024	447																								
	masa administrative (gjoba)																								
			Faleminderit																						

		6. Listën e plotë të subjekteve ndaj të cilave janë marra masa administrative nga Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit në vitin 2023. 7. Listën e plotë të subjekteve ndaj të cilave janë marra masa administrative nga Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit në vitin 2024.				
4	27.02.2025	Kërkesë për Informacion mbi Amnistinë e Gjykatave Bazuar në ligjin nr. 119/2014 PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT mbështetur në nenin 3 të këtij ligji.	10.03.2025	E nderuar Bazuar në kërkesën tuaj për informacion mbi amnistinë e gjykatave për subjektin me NIPT:, në emër të subjektit, për dënimin me gjykatë nr., ju njoftojmë se, sipas	E plotë	Nuk ka

		Po ju shkruaj për të kërkuar informacion në lidhje me amnistinë e gjobave, pasi kam lexuar se Neni 2 Përfituesit 1. Individët dhe/ose personat fizikë apo juridikë, të cilët kanë bërë ndërtime dhe/ose ndërhyrje pa leje apo njoftim paraprak, në ndërtime për qëllime banimi, në objekte ku kryhen veprimtari të prodhimit, magazinimit, përpunimit, ruajtjes dhe tregtimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale, si dhe mbajtjes të mjeteve të punës e inputeve bujqësore dhe blegtorale. 2. Individët dhe/ose personat fizikë apo juridikë, të cilët kanë objekt të aktivitetit të tyre		nenit 2 të ligjit 127/2024, përfitues të amnistisë janë: 1. Individët dhe/ose personat fizikë apo juridikë, të cilët kanë kryer ndërtime dhe/ose ndërhyrje pa leje apo njoftim paraprak, në ndërtime për qëllime banimi, në objekte ku kryhen veprimtari të prodhimit, magazinimit, përpunimit, ruajtjes dhe tregtimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale, si dhe mbajtjes së mjeteve të punës e inputeve bujqësore dhe blegtorale. 2. Individët dhe/ose personat fizikë apo juridikë, të cilët kanë objekt të aktivitetit të tyre prodhimin, përpunimin, ruajtjen dhe tregtimin e		
--	--	---	--	--	--	--

	prodhimin, përpunimin, ruajtjen dhe tregtimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale në zonat rurale. 3. Individët dhe/ose personat fizikë apo juridikë, të cilët nuk kanë zbatuar rregullat e vendosura për administrimin e situatës COVID-19 gjatë periudhës së pandemisë. Pasi jam gjobitur nga IKMT Vendimi nr. 20, datë 12.02.2024 Për dënimin me gjobë nr. serie për një strukturë druri të çmontueshme. Veprimtaria ime ka qënë ne mirmbajtjen e zones si dhe tregetimin promovimin e produkteve agroushqimore, produkteve artizanale ...(sikurse		produkteve bujqësore dhe blegtorale në IKMT ju informon se objekti juaj bën pjesë në fushën e shërbimit. Faleminderit,		
--	--	--	---	--	--

		është e pasqyruar ne ekstraktin tim bashkalidhur) Vendi zhvillimit ka qen ne zonen rurale Fshati Navosel Përmet Ju lutem, më informoni nëse unë jam përfitues i kësaj amnistie dhe cilat janë hapat që duhet të ndjek për të përfituar nga kjo mundësi. Me respekt Faleminderit për ndihmën tuaj!				
5	06.03.2025	Përshkruani çdo veprim të pretenduar si shkelje nga Institucioni Publik dhe nëse dispononi dokumente bashkëlidhni ato. Më 11 shkurt 2025 i kemi bërë një kërkesë për informacion Inspektoriatit Kombëtar të	19.03.2025	Përshëndetje, Në përgjigje të kërkesës tuaj drejtuar Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nr.1727 prot., datë 12.03.2025 në lidhje me pretendimet për mosdhënie të informacionit nga ana e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes	E plote	Nuk ka

		Mbrojtjes së Territorit për listën e plotë të subjekteve ndaj të cilave janë marra masa administrative nga IKMT-ja për periudhën 2018-2024. Më 20 shkurt 2025 Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit nuk na ka vendosur në dispozicion listën e plotë të subjekteve, por na ka dhënë përgjigje statistikore e cila nuk lidhet me kërkesën tonë për informacion. Në këtë rast Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit është duke shkelur të drejtën që na mundëson ligji nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” i		së Territorit përsa i përket kërkesës suaj për informacion nëpërmjet e-mail-it për <i>“Listën e plotë të subjekteve ndaj të cilave janë marrë masa administrtrive nga IKMT-ja gjatë periudhës 2018-2024”</i>, ju bëjmë më dije se: Për sa paraqitet në këtë kërkesë, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit ju ka mundësuar të dhëna faktike dhe statistikore në lidhje me gjobat si masa administrative të marra nga IKMT-ja për secilin vit të periudhës 2018-2024. Bazuar në ligjin nr.9887/2008 <i>“Për mbrojtjen e të dhënave personale”</i>, i ndryshuar si dhe në ligjin 119/2014 <i>“Për të drejtën e informimit”</i>, neni 17 mbi kufizimin e të drejtës për informim, në ligjin	
--	--	--	--	---	--

		ndryshuar, ku edhe mosdhënia e informacionit quhet refuzim. Përshkruani çfarë kërkon nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në përputhje me nenin 24 të ligjit nr.119/2014. Nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit kërkojmë që ta detyrojë Inspektoriatin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, që të respektojë ligjin nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” i ndryshuar pasi ky është informacion publik për të cilin ne kemi të drejtë të informohemi dhe të na vendos në dispozicion informacionin e kërkuar në mënyrë të plotë brenda afateve të përcaktuara sipas ligjit në fuqi.		nr.84/2016 “<i>Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit</i>” dhe në ligjin nr.109/2016 “<i>Për procedurat administrative</i>”, ju informojmë se: Lista e subjekteve në interesin tuaj përfshin emra të individëve të lidhur me shkeljen, ndaj sipas ligjit aplikohen kufizime me qëllim mbrojtjen e privatësisë së tyre. Në disa raste, masat administrative të dhëna nga IKMT-ja ndër vite janë në procese gjyqësore dhe si rrjedhojë publikimi i tyre është i ndaluar deri në përfundim të procesit ose të apelimit të vendimeve të marra nga autoritetet përkatëse. Gjithashtu, disa subjekte mund të jenë pjesë e një shqyrtimi administrativ në proces. Informacioni për emrat e subjekteve të gjobitur është i		
--	--	---	--	---	--	--

			ndjeshëm dhe mund të ndikojë negativisht në reputacionin e individëve dhe bizneseve. Ligji garanton mbrojtjen e këtyre të dhënave për të shmangur diskriminimin ose dëmtimin e reputacionit pa një arsye të ligjshme. Duke marrë në konsideratë rrezikun e dëmtimit të marrëdhënieve të punës dhe bashkëpunimit me subjektet e caktuara të prekura nga inspektimet dhe ndëshkimet për shkak të publikimit të informacionit, <i>Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit shpreh bashkëpunimin e tij për çdo informacion në interesin tuaj, për aq kohë sa ky " Nuk ndikon ndikon në mbarëvajtjen e procedurave të inspektimit" (ligji 119/2004, neni 17, pika 2.ç).</i>		
--	--	--	---	--	--

				Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,		
6	10.03.2025	DREJTUAR: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, Këshilli Kombëtar i Ujit OBJEKTI: Kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion dokumentacioni 1- Çfarë lejesh disponon kompania “Gjoka Konstruksion” në Njësinë Administrative Zall-Dajt në shfrytëzimin e zonës së rrethuar krah “Rrugës së Arbit” (Lokacioni Google këtu:			Ne prces	

		https://maps.app.goo.gl/oggzf9ipEJppDGSQA) që ndodhet në bashkimin e Lumit të Tiranës dhe Lumit të Selitës? Ju lutem listoni lejet e dhëna (nga institucioni juaj) dhe periudhat e vlefshmërisë së tyre (nëse aplikohet vlefshmëri kohore). 2- A disponon “Gjoka Konstruksion” leje për prodhim asfalti (ngrohje dhe distilim katrani e bitumi) në këtë zonë? Nëse po, ju lutem më siguroni një kopje elektronike (format PDF) të lejes përkatëse. 3- A disponon “Gjoka Konstruksion” leje për shfrytëzimin e mbetjeve dhe sedimenteve të Lumit të Tiranës në lokacionin e përmendur? Nëse po, ju lutem më siguroni një kopje elektronike (format PDF) të lejes përkatëse.			
--	--	---	--	--	--

		4- A ka kryer ndonjëherë inspektim Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit për veprimtarinë e kompanisë “Gjoka Konstruktion” në lokacionin e përmendur. maps.app.goo.gl Duke ju falënderuar paraprakisht për bashkëpunimin, mbetem në pritje të përgjigjes suaj!				
7	12.03.2025	Shkresë nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit, e regjistruar me nr. rendor 7 dhe nr. protokolli 1727 tonën, datë 12.03.2025, mbi ankimimin për mosdhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare, në lidhje me kërkesën me nr. rendor 5, datë 06.03.2025.	23.04.2025	Përsëndetje, Në vijim të kërkesës suaj për informacion me Nr. 6 Rendor, po ju përcjellim të dhënat e kërkuara në lidhje me listen e subjekteve ndaj të cileve janë marrë masat administrative (gjobë) të vendosura nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT) gjatë periudhës 2018-2024, si më poshtë:	E plote	Nuk ka

				Faleminderit.		
8	03.04.2025	Përshëndetje, Unë ... paraqes këtë ankesë ndaj Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit (IMT) për shmangien e përgjegjësisë dhe mungesën e një ekspertize teknike të saktë në lidhje me dëmet e shkaktuara në banesën time. Nga inspektimi i IMT-së, Nr protokoll 3424/2 është konstatuar që ka rrjedhje te vazhdueshme uji dhe prek direkt banesën mbi apartamentin tim, por pa asnjë provë konkrete, pa verifikim teknik të specializuar dhe duke përdorur vetëm “fotografi në mot të lagësht dhe të thatë”. Në këtë mënyrë, IMT po favorizon palën përgjegjëse, fqinjit në katin e	14.04.2025	Përshëndetje, Nëpërmjet këtij e-maili dëshirojmë t’iu informojmë në lidhje me problematikën tuaj, trajtuar nga Inspektorati Kombëtarë i Mbrojtjes së Territorit, të cilën po u'a përcjell nëpërmjet këtij e-maili. Në zbatim të ligjit Nr.107/2014“Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, neni 3, pika 20 dhe 21 përcaktohet se: <i>“Ndërtim” është çdo objekt që ndërtohet ose instalohet në territor, me vendosje të palëvizhme apo të përkoshme, dhe që zhvillohet nën dhe/ose mbi tokë. “Ndërtim/punim pa leje” janë ato procese dhe/ose objekte ndërtimore të kryera në mungesë të lejes së ndërtimit,</i>	E plote	Nuk ka

	katërt, i cili ka kryer një ndërhyrje të paautorizuar në strukturën e pallatit, duke shkaktuar këto dëmtime. Për më tepër, dëmtimi në apartamentin tim është i brendshëm dhe është verifikuar nga teknikë të fushës, të cilët kanë konfirmuar që burimi i lagështirës është ndërhyrja e paligjshme në lavamanin t dhe jo amortizimi i pallatit. Kjo situatë prek një mur mbajtës, duke rrezikuar sigurinë e strukturës. IMT, në vend që të merrte masa konkrete, ka nxjerrë një justifikim të përgjithshëm, duke pretenduar se problemi është “jashtë juridiksionit të saj”. Kjo është e papranueshme, pasi dëmtimi është rezultat i një ndërhyrjeje të paautorizuar që bie nën	<i>deklaratës paraprake për kryerjen e punimeve ose të kryera në kushtet e një lejeje të shfuqizuar.</i> Në këtë kuptim, çdo objekt i ndërtuar në këto kushte, i nënshtrohet inspektimit të territorit, në zbatim të ligjit Nr.9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” i ndryshuar. Gjatë momentit të inspekimit, IMT Bashkia Tiranë nuk ka konstatuar punime në proces dhe për këtë nuk mund të ndërhyhet. Ju falenderojmë paraprakisht për mirëkuptimin.		
--	--	--	--	--

		përgjegjësinë e IMT-së dhe institucioneve përgjegjëse të Bashkisë Tiranë. Kërkoj që: 1. Të kryhet një ekspertizë e pavarur teknike nga një inxhinier ndërtimi të licencuar, për të përcaktuar burimin real të lagështirës dhe dëmtimet në murin mbajtës. 2. Të merren masa ligjore ndaj subjektit, si person përgjegjës për dëmtimet, dhe të detyrohet të riparojë dëmet e shkaktuara. 3. IMT të rishikojë vendimin e saj dhe të mos favorizojë palën përgjegjëse, por të marrë masa sipas detyrimeve të saj ligjore.				
9	24.04.2025	Pershendetje, Brema Ambiente dhe HSEM (Health Safety Environment Management), kanë kënaqësinë	25.04.2025	Përsëndetje, Në adresën e institucionit (<i>info@ikmt.gov.al</i>) ka mbërritur ftesa për pjesëmarrje në eventin e organizuar nga Brema Ambiente	E deleguar	Nuk ka

		t'ju ftojnë të merrni pjesë në eventin : <i>“Siguria në Punë, Menaxhimi i Mbetjeve & Mjedisi”</i> Për më shumë informacion ose për të konfirmuar pjesëmarrjen tuaj, ju lutemi na kontaktoni në email ose ne numrin : +355 69 542 0190.		dhe HSEM (Health Safety Environment Management), me temë: “Siguria në Punë, Menaxhimi i Mbetjeve & Mjedisi” Bashkëlidhur po ju dërgoj ftesën e cila përmban dhe kontaktin për të konfirmuar pjesëmarrjen. Faleminderit!		
10	05.05.2025	Përsëritje. Në vijim gjeni email e dërguar nga Shërbimet e Policisë Bashkiake të Tiranës, lidhur me konstatimin	19.08.2025	Përsëritje, Duke u bazuar në ankesat e ardhura pranë Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT), nga Drejtoria e Inspektimit të Mjedisit	E plote	Nuk ka

		mbi ndotjen e liqenit artificial të Tiranës. Punë të mbarë! Pershendetje! Sherbimet e Policise Bashkiake te Tiranese kane konstuar, mbi ndotjen e liqenit artificial te Tiranes, ujë ngjyrë jeshile dhe erëra të pa këndshme si dhe peshq të ngordhur. Të njoftohen Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit. Pune te mbare!		dhe Ujërave është ngritur një grup pune, i cili ka kryer verifikime në disa pika të caktuara, ku u konstatua ndotje. Nga këto verifikime rezultoi se ndotja shkaktohej nga përzierja e ujërave të bardha me ujërat e ndotura urbane, për shkak të mosfunksionimit ose mungesës së sistemit të kanalizimeve në këtë zonë. Këto rrjedhje të lira burojnë nga tombinat e rrugëve dhe përzihen me ujërat e ndotura që vijnë nga zona e urbanizuar, konkretisht nga zona e Liqenit të Thatë, duke u shkarkuar në “Liqenin Artificial” të Tiranës dhe duke shkaktuar ndotjen e ujit. Për këtë arsye, IKMT ka dërguar shkresë për kompetencë shoqërisë “Ujësjiellës Kanalizime Tiranë–Sharrë”, me anë të së cilës është kërkuar marrja e masave të		
--	--	---	--	---	--	--

				menjëhershme për diferencimin e ujërave të bardha nga ato të ndotura, rehabilitimin e sistemit të kanalizimeve, si dhe mbylljen/izolimin e pikave që shkarkojnë ujëra të ndotura në sistem. Gjithashtu, për rastet e konstatuara të ndotjes në zonën e Liqenit Artificial, IKMT ka marrë masa ndaj subjekteve që shkarkonin ujëra të ndotura në liqen. Për këto shkelje është vendosur gjobë ndaj subjekteve përgjegjëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Bashkëlidhur gjeni vendimet e marra. Faleminderit.		
11	08.05.2025	Përsëndetje, Bashkëlidhur do të gjeni Kërkesën për informacion.	28.05.2025	Pershendetje, Në përgjigje të kërkesës suaj, dërguar në IKMT, nëpërmjet adresës elektronike, ku mbështetur	E plote	Nuk ka

		Në pritje të një përgjigjeje sa më të shpejtë nga ana juaj, Faleminderit për bashkëpunimin.		në Ligjin Nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, kërkohet informacion mbi situatën e konstatuar nga ana juaj në territorin e Bashkisë Shijak, ju bëjmë me dije si më poshtë vijon: Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, nëpërmjet strukturave të saj nën varësi dhe përkatësisht Drejtorisë së Inspektimit në Mjedis dhe Ujëra, fillimisht ka komunikuar me sektorët përkatës të Drejtorisë Rajonale të IKMT-së Qarku Durrës, për t’u informuar nëse nga ana e kësaj drejtorie kishte informacion mbi këtë situatë tepër shqetësuese. Nga ky komunikim jemi informuar se kjo drejtori dhe në muajin Mars dhe përgjatë muajit Prill ka dërguar shkresa informuese në Bashkinë Shijak mbi konstatimin që është kryer në terren nga ana e tyre, të situatës së keqmenaxhimit të		
--	--	---	--	--	--	--

				mbetjeve që krijohen brenda njësisë administrative. Në të dyja rastet Bashkia Shijak ka informuar se së fundmi ka hasur në një ngërç burokratik në mardhënie me landfillin e Sharrës, ngërç i cili pritet të zgjidhet sa më shpejt. Pasi Drejtoria e Inspektimit të Mjedisit dhe Ujërave në IKMT, ka marrë këtë informacion më datë 20.05.2025 ka hapur në sistemin unik <i>e-inspektimi</i>, një çështje për inspektim on-line kundrejt Bashkisë Shijak me Nr.-IKMT-DQ-2025-000139, me objekt inspektimi <i>“Bazuar në informacionet e marra nga mediat audio-vizive si dhe verifikimi në terren, kontroll mbi zbatueshmërinë e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e mjedisit dhe atij të posaçëm për menaxhimin e integruar të Mbetjeve”</i>		
--	--	--	--	---	--	--

				Në përfundim të këtij inspektimi i cili filloi në ora 09.00 dhe mbaroi në orën 14.00, të datës 20.05.2025, trupa inspektuese e D.I.M.U-së, mbajti Proçes-Verbalin e konstatimit të kundravajtjes administrative me Nr.IKMT-DQ-2025-000139-2, kundrejt drejtuesit të njësisë qeverisjes vendore, kjo në zbatim dhe referuar Ligjit Nr.10433, datë 16.06.2011, “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, neni 45 dhe Ligjit Nr.10463, datë 22.9.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të mbetjeve” (Ndryshuar me ligjin nr. 32/2013, datë 14.2.2013; nr. 156/2013, datë 10.10.2013; nr. 28/2022, datë 17.3.2022; nr. 70/2024, datë 4.7.2024) (I përditësuar), Neni 21, pika 12 dhe Neni 62, Kundërvajtjet dhe sanksionet (shtuar pika 63 me ligjin nr. 32/2013, datë 14.2.2013;		
--	--	--	--	---	--	--

				ndryshuar pika 48, shfuqizuar pika 51 me ligjin nr. 156/2013, datë 10.10.2013; shtuar pika 25/1 me ligjin nr. 28/2022, datë 17.3.2022; ndryshuar me ligjin nr. 70/2024, datë 4.7.2024), pika 11. Nëpërmjet këtij Proçes-Verbali organi inspektues ka urdhëruar/komunikuar drejtuesit të qeverisjes vendore marrjen e masave urgjente për rehabilitimin dhe pastrimin e vendeve (akse rrugore, lagje, sheshe,etj) të ndotura nga mbetjet urbane të përziera dhe njëkohësisht fillimin e operacioneve për rehabilitimin pastrimin e vend depozitimit në zonën e Hardhishtes. Njëkohësisht ju bëjmë me dije se strukturat e Bashkisë Shijak më datë 22.05.2025, kanë filluar nga puna në terren me një intesitet të kënaqshëm për plotëzimin e detyrave të lëna nga ana e organit inspektues dhe		
--	--	--	--	---	--	--

				informojnë institucionin tonë në çdo moment dhe në kohë reale mbi zhvillimet e operacioneve të rehabilitimit/pastrimit, i gjithë ky informacion pasi konfirmohet dhe nga ana e trupave inspektuese në terren, pasqyrohet sistematikisht në sistemin e inspektimit. Në përfundim ju informojmë se IKMT, me strukturat e saj nën varësi është në mbikqyrje të vazhdueshme të situatës mbi të cilën keni kërkuar informacion, dhe në zbatim të detyrave të saj funksionale do të vazhdojë të jetë operative në terren, për të konfirmuar/kontrolluar kryerjen e detyrave të lëna nënshkrimi të qeverisjes vendore, Bashkia Shijak. Duke ju falenderuar për mirëkuptimin !		
--	--	--	--	---	--	--

12	05.03.2025	Përsëhëndetje, Dua të denoncoj një ndotje të madhe të mjedisit që po i bëhet gjithë lumit Erzen nga një subjekt privat që po ndërton një hidrocentral në fshatin Hekal, përballë Pellumbasit. Unë jam një guidë që çdo vit shoqëroj të huaj në shpellën e Pellumbasit dhe në grykën e Skoranës, poshtë shpellës. Kjo grykë është një ndër vendet më të vizituara nga të huajt në Tiranë, me ujëvarat dhe zgavrat e mrekullueshme që ka. Fatkeqësisht, kjo zonë dhe ky turizëm janë dëmtuar nga veprimet e një firme që po kryen punime për ndërtimin e një hidrocentrali, si dhe nga	28.05.2025	Përsëhëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj me Nr. 11, datë 03.05.2025, ju njoftojmë se Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit ka ngritur një grup pune i cili do të kryejë inspektim në zonën përreth lumit Erzen, me qëllim verifikimin e situatës së paraqitur në denoncimin tuaj lidhur me ndotjen mjedisore. Pas përfundimit të inspektimit dhe shqyrtimit të të gjitha rrethanave të konstatuara në terren, do të merren masat përkatëse në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe do të jeni i informuar mbi ecurinë dhe rezultatet e mëtejshme të procesit. Ju falënderojmë për bashkëpunimin.	E plote	Nuk ka
----	------------	--	------------	---	---------	--------

		neglizhenca e strukturave shtetërore. Kjo firmë ka hapur një tunel në digën e Skoranës dhe ka derdhur në lumë gjithë llumin dhe mbeturinat që kjo digë ka mbledhur prej dhjetëra vitesh. Sipas banorëve të fshatit Pellumbas, ata e kanë kundërshtuar këtë veprim, por nuk janë dëgjuar nga askush. Ky llum dhe këto mbeturina kanë dëmtuar rëndë gjithë lumin, duke e kthyer nga një lumë me ujë kristal në një lumë me ujë të ndotur dhe baltë, duke dëmtuar çdo gjë në rrjedhën e tij. Gjithë shtrati i lumit është mbushur me baltë dhe do të duhet shumë kohë për t'u rikuperuar. Zgavrat fantastike që tërhiqnin turistë janë				
--	--	---	--	--	--	--

		tani të shëmtuara dhe të dëmtuara nga lluca dhe uji i ndotur. Është e çuditshme sesi kjo situatë nuk është vënë re nga inspektoratet shtetërore, kur edhe nga autostrada dallohet qartë uji i ndotur që vjen nga lart. Kjo kompani, në vend që t'i pastrojë dhe t'i largojë mbeturinat me kamionë, i derdh të gjitha në lumë, duke i shkaktuar një dëm kolosal dhe të pariparueshëm mjedisit dhe të gjithëve ne që jetojmë dhe punojmë në këtë zonë. Banorët e Pellumbasit kanë lajmëruar inspektorët që kanë ardhur në fshat, por përgjigjja e tyre ka qenë: “Do t'i thërrasim,” dhe kanë refuzuar të shkojnë në vendin ku ndodh ndotja, me pretekstin se rruga është e vështirë dhe nuk kanë automjet të				
--	--	---	--	--	--	--

		përshtatshëm për të shkuar deri tek diga e Skoranës. Atje ku, në fshehtësi, kjo firmë ka kryer një krim të rëndë mjedisor. Kjo neglizhencë e organeve shtetërore po falimenton biznesin tonë, pasi këtë vit ka një rënie drastike të vizitorëve, dhe po ashtu po shkatërron një nga zonat më të bukura të Tiranës. Kemi informacion të sigurt që inspektorët janë kontaktuar nga përfaqësuesit e kësaj firme dhe janë “rregulluar” me forma të ndryshme, duke i injoruar denoncimet në këmbim të favoreve – diçka që e thonë të gjithë banorët e fshatit. Kërkojmë nga ana juaj marrjen e masave të menjëhershme për ndalimin e derdhjes së mbeturinave të digës së Skoranës				
--	--	---	--	--	--	--

		në lumin Erzen, si dhe të ndërpritet çdo lloj ndotjeje e këtij lumi në këtë zonë. Nëse nuk merren masa të menjëhershme, do t'i drejtohem i organeve përkatëse për të bërë kallëzim penal ndaj të gjithë atyre që kanë neglizhuar këtë çështje dhe që vazhdojnë ende të jenë indiferentë përballë këtij krimi mjedisor. Dua t'ju njoftoj se, nëse nga drejtuesi i institucionit tuaj nuk ndërhyhet menjëherë, do të bëj denoncim online në platformën e SPAK për shpërdorim detyre ndaj të gjithë drejtuesve të përfshirë, si dhe në Prokurorinë e Tiranës, duke përfshirë edhe këtë email dhe këtë denoncim si provë.				
--	--	--	--	--	--	--

		Duke pasur besim se kjo çështje do të merret seriozisht.				
13	28.05.2025	Përschendetje, Bashkëlidhur do të gjeni Kërkesën për informacion si dhe linkun si më poshtë: https://www.youtube.com/watch?v=3F0Ht4vGnIk Në pritje të një përgjigjeje sa më të shpejtë nga ana juaj, Faleminderit për bashkëpunimin.	03.06.2025	Pershendetje Në përgjigje të kërkesës suaj, dërguar në IKMT, nëpërmjet adresës elektronike, ku mbështetur në Ligjin Nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, kërkohet informacion mbi situatën e konstatuar nga ana juaj në territorin e Bashkisë Krujë, ju bëjmë me dije si më poshtë vijon: Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, nëpërmjet strukturave të saj nën varësi dhe përkatësisht Drejtorisë së Inspektimit në Mjedis dhe Ujëra, bazur në urdhërin e punës Nr,254, datë 20.05.2025, si dhe nga informacionet e marra nga mediat audio visive, më datë 20.05.2025 u	E plote	Nuk ka

				verifikua dhe kontrollua zona Kodër-Dollak Fushë Kruje, Bashkia Krujë. Pas verifikimit të kryer trupa inspektuese mbajti Procesverbal Inspektimi, me Nr. IKMT-DQ-2025-000137-2 duke marr masat administrative përkatëse, kundrejt drejtuesit të njësisë qeverisjes vendore, kjo në zbatim dhe referuar Ligjit Nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, neni 45 dhe Ligjit Nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të mbetjeve” (Ndryshuar me ligjin nr. 32/2013, datë 14.2.2013; nr. 156/2013, datë 10.10.2013; nr. 28/2022, datë 17.3.2022; nr. 70/2024, datë 4.7.2024) (I përditësuar), Neni 21, pika 12 dhe Neni 62, Kundërvajtjet dhe sanksionet (shtuar pika 63 me ligjin nr. 32/2013, datë 14.2.2013;		
--	--	--	--	---	--	--

				ndryshuar pika 48, shfuqizuar pika 51 me ligjin nr. 156/2013, datë 10.10.2013; shtuar pika 25/1 me ligjin nr. 28/2022, datë 17.3.2022; ndryshuar me ligjin nr. 70/2024, datë 4.7.2024), pika 11. Bashklidhur do të gjeni Procesverbalin e Inspektimit. Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,		
14	10.06.2025	Përshëndetje. Pranë Inspektoratit Qendror është administruar në formë elektronike kërkesa për informacion, përmes së cilës kërkon informacion si vijon : 1. <i>Sa gjoba mjedisore janë vendosur gjatë vitit</i>	24.06.2025	Përshëndetje, Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, në bazë të Ligjit nr. 119/2014, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”, ju informojmë si më poshtë: 1. Sa gjoba mjedisore janë vendosur gjatë viteve 2022, 2023	E plote	Nuk ka

		2024, 2023 dhe 2022? Po për periudhën janar- prill të këtij viti? *të dhënat e ndara sipas viteve. 2. Sa prej gjobave të vitit 2024 janë vendosur ndaj individëve dhe sa ndaj subjekteve juridike (biznese, institucione)? 3. Cilat janë shkeljet më të zakonshme për të cilat është vendosur gjobë? 4. Sa është vlera totale e gjobave të vendosura gjatë vitit 2024? Po gjatë vitit 2025? 5. Cilat janë rastet konkrete më të shpeshta ku janë vendosur masa ndaj individëve dhe për çfarë lloj ndotjeje kryesisht?		dhe 2024? Po për periudhën janar–prill të vitit 2025? Gjatë viteve në fjalë, nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit janë vendosur: - Në vitin 2022: 12 gjoba - Në vitin 2023: 126 gjoba - Në vitin 2024: 160 gjoba - Në periudhën janar–prill 2025: 24 gjoba 2. Sa është vlera totale e gjobave të vendosura gjatë vitit 2024? Po gjatë periudhës janar–prill 2025? - Vlera totale e gjobave të vendosura gjatë vitit 2024 është 141,100,300 lekë - Ndërsa për periudhën janar–prill 2025, vlera totale është 35,730,000 lekë 3. Sa prej gjobave të vitit 2024 janë vendosur ndaj individëve dhe sa ndaj subjekteve juridike (biznese, institucione)?	
--	--	--	--	---	--

		Sa më sipër, në zbatim të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, në vijim ju dërgojmë për kompetencë kërkesën për informacion. Faleminderit.		Nga numri total i gjobave të vendosura gjatë vitit 2024: • 21 gjoba janë vendosur ndaj individëve; • 139 gjoba janë vendosur ndaj subjekteve juridike (biznese dhe institucione); Duke qenë se numri total i gjobave për vitin 2024 është 160, do të thotë se të njëjtat subjekte janë gjobitur më shumë se një herë gjatë vitit. Pjesa tjetër e gjobave i përket rasteve kur të njëjtat subjekte janë gjobitur më shumë se një herë gjatë vitit. 4. Cilat janë shkeljet më të zakonshme për të cilat janë vendosur gjoba? Shkeljet më të shpeshta për të cilat janë vendosur masa administrative kanë të bëjnë kryesisht me shkelje	
--	--	--	--	---	--

				të Ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” dhe shkelje të Ligjit nr. 111/2012 “Për burimet ujore”, i ndryshuar. 5. Cilat janë rastet më të zakonshme ku janë vendosur masa ndaj individëve dhe për çfarë lloj ndotjeje kryesisht? Masa administrative ndaj individëve janë vendosur kryesisht në raste që lidhen me shfrytëzimin e paligjshëm të burimeve ujore dhe keqmenaxhimi i mbetjeve.		
15	13.06.2025	Përsëndetje , Në këtë kuadër, kërkoj me urgjencë nga institucioni juaj përgjigje dhe veprim ligjor për sa më poshtë:	16.06.2025	Përsëndetje , Drejtuar: DRIKMT Lezhë Në adresën e e-mailit të koordinatorit të të drejtës për informim, IKMT, është paraqitur kërkesa nga qytetarin, me nr. 15 Rendor, datë 13.06.2025, për	E deleguar	Nuk ka

		1. A ka ky ndërtim leje ndërtimi të lëshuar nga bashkia apo ndonjë institucion tjetër? 2. A është kryer ndonjë inspektim teknik apo mjedisor nga IKMT ose strukturat vendore? 3. Nëse objekti është pa leje, përse nuk është ndërmarrë masa për prishjen apo pezullimin e veprimtarisë? 4. A është matur ose vlerësuar ndotja akustike që ky aktivitet shkakton në mënyrë të përditshme? Në rast të mosmarrjes së një përgjigjeje brenda afatit ligjor, do të jem i detyruar të ndjek çështjen pranë Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), për mosveprim institucional, shpërdorim detyre, si dhe		informacion mbështetur në Ligjin nr. 119/2014, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”. Ku kërkon: 1. A ka ky ndërtim leje ndërtimi të lëshuar nga bashkia apo ndonjë institucion tjetër? 2. A është kryer ndonjë inspektim teknik apo mjedisor nga IKMT ose strukturat vendore? 3. Nëse objekti është pa leje, përse nuk është ndërmarrë masa për prishjen apo pezullimin e veprimtarisë? 4. A është matur ose vlerësuar ndotja akustike që ky aktivitet shkakton në mënyrë të përditshme? Bëjmë me dije qytetarin se për ankesa në lidhje me ndotjen akustike duhet ti drejtoheni Policisë së Shtetit, Policisë Bashkiake,		
--	--	--	--	---	--	--

		mbrojtje të aktiviteteve të paligjshme. Qëllimi jonë është jeta e qete ne komunitet dhe ne vendin pallatin ku jetojmë! Per interesa te nje personi nuk ka pse te Shqetësohen me 10-tra familje fëmijët e pleq e njerez qe jetojnë e banojnë.		Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM). Bashkëlidhur po ju përcjellim kërkesën e paraqitur.		
16	13.06.2025	Përsëndetje , Subjekti i denoncimit: “Borebardha dhe 7 xhuxhat”] Lloji i veprimtarisë: Aktivitet turistik i paregjistruar dhe zaptim prone shtetërore/Bullizim ne rrjete sociale/filmimi i nxënësve pa pëlqimin e tyre ose të prindërve të tyre dhe shpërndarja	24.06.2025	I nderuar Në vijim të kërkesës suaj, po ju përcjellim informacionin si më poshtë nga DRIKMT Kukës: DRIKMT Kukes, Sektori i Pyjeve në zbatim te Urdherin te punes Nr.15 date 26.01.2024, beri kontroll ne objekt dhe u konstatua se nuk kishte ndertim ne zhvillim. Ishin vendosur 55 cope	E plote	Nuk ka

	e materialeve në rrjetet sociale (si TikTok) Përmbajtja e denoncimit: “Përmes kësaj letre/denoncimi, ju informoj se në zonën Zona B,Fierze(Tropoje), keta individ ka zaptuar një sipërfaqe të konsiderueshme të tokës shtetërore pa leje, e ka rrethuar me tel elektrik dhe e përdor për qëllime komerciale (duke e dhënë me qira përmes platformës Booking.com apo të ngjashme). https://www.booking.com/hotel/al/borbardha-the-7-xhuxhat.en-gb.html?aid=2311236&label=en-al-booking-desktop-O9wP3KzgPnoAoTUF9IEzlQS652796016699%3Apl%3Ata%3Ap1%3Ap2%3Aac%3Aap%3Aneg%3Afi%3Atikwd-65526620%3Alp9069992%3Ali	shtylla betoni per rrethimin e nje objekti (Ish Godina e Kinezve)Zona B ne pronesi te KESH.sha .Kostatuam nje siperfaqe 9300 m2,e pastruar nga shkurret. Pas verifikimeve ne terren kontaktuam ne telefon me pergjegjesen e Pyjeve Bashkia Tropoje ,ku kerkuam informacion mbi gjendjen kadastrale te kesaj siperfaqe Ngastra Nr.137, Ekonomia Pyjore Lugina T'Planit (Fierze Zona B) .Ku nuk rezulton pjese e fondit pyjor Bashkia Tropoje. Ne perfundim te inspektimit ne adresen e larte permendur u paraqit dhe Znj.Ajlin Alfredaj ku pretendon se ka dokumentacion te cilin nuk na e vendosi ne dispozicion. Nga IMT-Bashkia Tropoje na eshte vene ne dsipozicion korospodenca me ASHK-ne ku kjo siperfaqe toke		
--	---	--	--	--

	%3Adec%3Adm&sid=4bca023df0ad1b02e4b489b101ba3544&dist=0&group_adults=2&group_children=0&hapos=5&hpos=5&no_rooms=1&req_adults=2&req_children=0&room1=A%2CA&sb_price_type=total&sr_order=popularity&srepoch=1749841908&srpvid=f46086f66e0707cb&type=total&ucfs=1& Aktiviteti zhvillohet pa leje ndërtimi, pa licencë për ushtrim aktiviteti turistik dhe pa pagesë të detyrimeve tatimore ndaj shtetit. Ky veprim përbën shkelje të ligjeve në fuqi dhe dëmton interesin publik, duke rrethuar me tel elektrik faqen e malit që është hapësirë publike dhe nuk ju takon ta rrethojnë. Kane vite që operojnë me aktivitete të jashteligjishme, mes të cilave dhe		është në pronesi të KESH-it si dhe stauts shtet. Gjithashtu në përgjigje të ankesës datë 25.04.2025 u ngrit grupi i punës DRIKMT Kukes Sektori i Pyjeve me Urdherin e Punës Nr 90 Prot datë 06.05.2025, inspektim në vendin e quajtur Zona B Fierze. Grupi i punës ka bërë rikontroll të ushtruar në Objektivin Zona B Fierze, Ek. Pyjorë Lugina e T' Planit ngastrë 137/b për të verifikuar gjendjen faktike të kësaj zone, pasi është bërë dhe një inspektim në vitin 2024. Gjate këtij kontrolli u konstatua zënje të një sipërfaqeje pyjorë rreth 3 ha e cila ishte rrethuar me shtylla e tel kambjon. Në vendngjarje nuk ishte njeri. Për këtë problematikë i jemi drejtuar dy herë me shkresë Drejtorisë së Administrimit të Pyjeve dhe		
--	---	--	---	--	--

		me pune te pista per te cilat nuk kam video apo prova per tju ofruar.PJu lutem merrni masat e nevojshme ligjore.”Kane kryer blerjen e pronave pa një kontratë shitblerje dhe pa regjistrimin e duhur duke thyer Ligji nr. 27/2018 – "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme" Subjekti ka 6 vite qe operon dhe se fundmi ka nisur te zaptoje me shume territor qe nuk i perket.Per tju shmangur pergjegjesise se tatimeve personi ne fjale fshin dhe rikrijon profilin ne booking.Po ju bashkangjis dhe nje video qe demonstroi rrethimin e paligjshem qe eshte kryer,nxenesit minoren qe jan filmuar pa lejen e tyre apo te prinderve te tyre.Per me teper personi Ajlin Alfredaj ne rrjetin social tik-tok permend emra te		Kullotave, Bashkise Tropoje duke qene dhe pronare e Fondit Pyjor, per masat qe kan marr ne lidhje me kete problematike. Jemi ne pritje te pergjigjes nga ana e Bashkise Tropoje. Bashkelidhur ju dergojme dokumentat e permendura te vitit 2024 si dhe dokumentat e vitit 2025 dhe foto nga inspektimet e kryera. Faleminderit,		
--	--	---	--	--	--	--

		ndryshem te personave mes te cilet dhe emri im duke bullizuar pa te drejte.Femijet i dergojme ne shkolle qe te mesojne,jo qe te behen vegla te personave te treta per te marre vemendje ne rrjetet sociale Personi Alfred Alfredaj ka qene i arrestuar me pare per shperdorim detyre,po ashtu dhe Ajlin Alfredaj qe ka kryer krime te tjera gjate kohes qe ka punuar ne kadaster Personat ne fjale po shkaktojne shume trazira ne te njejten lagje duke u bere problem per banoret e tjere te cilet ndihen dhe te intimiduar dhe te pashprese pasi personat ne fjale jane marre me perpara me persona te tjere qe jane marre me kultivimin e lendeve narkotike.				
--	--	---	--	--	--	--

		Ligjet e shkeluara (te pakten kto i ka shkelur) Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 – "Për mbrojtjen e të dhënave personale"/Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë – Neni 189/Ligji për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit (Ligji nr. 107/2014) – Kodi Penal – Neni 199/a: Ndërtimi i paligjshëm/Kodi Penal – Neni 248: Shpërdorimi i pronës publike/Kodi Penal – Neni 180: Fshehja e të ardhurave - Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë – Neni 526 "Për Marrëveshjet e Shitjes" Shkelja: Pa një kontratë të nënshkruar, nuk ka një marrëveshje të qartë dhe të ligjshme për kalimin e pronës.				
--	--	--	--	--	--	--

		Kjo do të thotë që nuk ka një bazë ligjore për të transferuar pronësinë dhe për të garantuar që prona ka kaluar nga shitësi tek blerësi. Ne video shihen personi Ajlin Alfredaj që punon në një parcele toke që nuk është e saja,po është toke shtetërore,me qëllim përvetësimin e asaj prone pa të drejtë.I njëjti person që në video në ambientet e shkollës me nxënës minorene dhe i nxjerr në tiktok Gjeja më e keqe është që kanë aq kurajo sa të rrethojnë malin me tel elektrik(token e të gjithëve) dhe e nxjerrin në tiktok Ju lutem bëni dicka				
--	--	--	--	--	--	--

17	16.06.2025	Në kuadër të transparencës publike, duke u bazuar tek ligji nr. 119/2014 “Për të Drejtën e 1. Cilat janë masat e ndërmarra ndaj subjekteve të përpunimit dhe nxjerrjes së hidrokarbureve në zonën e Fierit që kanë ndotur ambientin dhe lumin Gjanica? Ju lutem, listoni emrin e subjekteve për këto raste për periudhën 1 janar 2018 – 30 Maj 2025.			Ne proces	Nuk ka
18	18.06.2025	Përsëndetje, Me datë 23.04.2025 subjekti Frigo Alba me NIPT K51725005T me adresë rruga e Limuthit, Kashar Tiranë, ka kryer asgjësimin e 4516,75 kg mish fileto derri indentifikuar me <i>salmonelë spp</i> sipas raport provës nr. 37/36 datë 24.01.2025 të laboratorit të DRAKU Tiranë	20.06.2025	Përsëndetje Në vijim të kërkesës suaj për informacion me Nr. 18 Rendor, datë 18.06.2025, po ju përcjellim të dhënat e kërkuara, si më poshtë: Cila është fusha e përgjegjësisë ligjore e institucionit të IKMT-së për të kryer procedurë inspektimi	E plote	Nuk ka

		dhe konfirmuar nga laboratori i ISUV me nr. U-137-25 datë 23.01.2025. Sipas kërkesës së subjektit Frigo Alba datë 16.04.2025 drejtuar institucioneve përgjegjëse, në procedurën e asgjesimit ka marrë pjesë dhe Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit në rolin e mbrojtjes së mjedisit. Lutemi referuar praktikës së inspektimit me autorizim nr. IKMT-DO-2025-000115-1, dhe nr. 2221/1 prot., datë 22.04.2025, të kryer nga inspektorët e IKMT-së kërkoj: 1. Cila është fusha e përgjegjësisë ligjore e institucionit të IKMT-së për të kryer procedurë inspektimi me objekt asgjësimin e produkteve me origjinë shtazore në		me objekt asgjësimin e produkteve me origjinë shtazore në Operatorët e Biznesit Ushqimor? 1. Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, nëpërmjet Drejtorisë së Inspektimit të Mjedisit dhe Ujërave e cila ka në përbërje sektorët: • Sektori inspektimit të Rezervave Ujore dhe Shkarkimeve në Mjedis dhe Ujëra; • Sektori inspektimit të Industrive dhe Veprimtarive Prodhuese; • Sektori inspektimit të Menaxhimit të Mbetjeve dhe Shkarkimeve të Lëngëta. Merr pjesë në procedura që kanë të bëjnë me nxjerrjen jashtë përdorimi (asgjësimin) e produkteve ushqimore të skaduara apo/dhe	
--	--	---	--	--	--

		Operatorët e Biznesit Ushqimor ? 2. Meqenëse fakti ka ndodhur, referuar ligjit nr. 10 463, datë 22.09.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve” a mund të sqaroni cili është destinacioni dhe produkti përfundimtar i përfituar gjatë këtij procesi ? Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,		dëmtuara, pjesmarrja është në përgjigje të kërkesës që subjektet dërgojnë pranë IKMT-së. Legjislacioni mbi të cilin i ushtrojmë këto detyra dhe funksione është si më poshtë cituar: • Urdhër i Ministrit të Brendshëm, Nr.424, datë 25/11/2020, neni 3, pika 2, neni 15. • Vendim nr. 893, datë 4.11.2015 për Organizimin dhe Funksionimin e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (ndryshuar me vkm nr. 513, datë 1.7.2020, nr. 606, datë 29.7.2020) (i përditësuar), Kreu I, pika 1 dhe 2, Statusi dhe Misioni. • Ligji 10.431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”		
--	--	---	--	---	--	--

				• Ligji 10463 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, i ndryshuar, datë 22.09.2011, neni 3 (Përkufizimet), neni 17, neni 19, neni 56, pika 1 dhe 2. • Ligji 10448 “Për Lejet e Mjedisit”, i ndryshuar, datë 14.07.2011, neni 3, pika 11 • Ligji 10433 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, datë 16.06.2011, neni 3 (Përkufizime), neni 27, neni 45 dhe neni 47. • VKM-ja Nr.402, datë 30.06.2021, “Për Miratimin e katalogut të Mbetjeve” • VKM-ja Nr.229, datë 23.04.2014, “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jotë rrezikshme dhe informacionin që duhet		
--	--	--	--	---	--	--

				të përfshihet në dokumentin e transferimit” • VKM-ja Nr.371, datë 11.06.2014, “Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe dokumentit të dorëzimit të tyre” • Shtojca 1 dhe Shtojca 2 të Ligjit 10463 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, i ndryshuar, datë 22.09.2011. 2.Meqenëse fakti ka ndodhur, referuar ligjit nr. 10 463, datë 22.09.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve” a mund të sqaroni cili është destinacioni dhe produkti përfundimtar i përfituar gjatë këtij procesi? Trajtimi i këtyre produkteve, të cilat janë deklaruar si të pa përshtatshme për konsumatorin kryhet mbi baza		
--	--	--	--	--	--	--

				profesionale dhe në përputhje me teknologji bashkëkohore. procesi në fjalë është i certifikuar dhe i licencuar nga autoritetet kompetente përkatëse dhe njihet me emrin “Rendering”. Ky proces i nënshtrohet mbetjeve me origjinë shtazore të cilat janë të kontaminuara ose jo (si psh produktet me afat të skaduar). Fillimisht mbetjet përpunohen përmes ndarjes manuale ku produkti diferencohet nga elementet e paketimit apo materiale të tjera të padobishme. Më pas mbetjetet transportohen në një enë grirëse (mulli) ku copëzohen dhe dërgohen në një cilindër brenda të cilit kryhet procesi i zierjes së këtij materiali me një temperaturë që arrin deri në 130 gradë celcius dhe me një presion atmosferik deri në 3 bar, proces i cili zgjat për 4-5 ore (në varësi të sasisë		
--	--	--	--	--	--	--

				për trajtim apo llojit të kontaminimit të produktit), kjo procedurë siguron eliminimin total të cdo lloj bakteri apo virusi. Pas përfundimit të kësaj faze produkti i përfituar i nënshtrohet një diferencimi më profesional i cili përfshin heqjen e ujit dhe avujve përmes presimit. Pasi materiali thahet plotësisht, përfitohet një sasi e lëngët që është produkt primar për vaj për Biodizel ndërsa sasia tjetër e thatë është produkt <i>pleh kompus organik</i>, të dy këto produkte të përfituara nga procesi i “Rendering” ambalazhohen dhe eksportohen në vendet e Bashkimit European (kryesisht Greqi). Ky proces zbatohet në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e mjedisit dhe atij të posacem për menaxhimin e		
--	--	--	--	---	--	--

				integruar të mbetjeve si dhe në përputhje me rekomandimet e Kapitullit 27 të manualit për asocim stabilizimin e BE, ku rekomandohet/kërkohet zbatimi i praktikave sa më të avancuara për riciklimin dhe trajtimin e mbetjeve duke mundësuar në këtë mënyrë ulje e ngarkesave të ndotjes në landfillet apo vende të tjera grumbullimi të mbetjeve. Ju falenderojmë paraprakisht për mirëkuptimin.		
19	20.06.2025	Te nderuar zoterinj. Zoterinjte po shkarkojne mbeturinat dhe llucen e diges poshte diges dhe ndotin mjedisin ne permasa te pariparueshme edhe ne momentin aktual.Dje kam qene me nje grup dhe perseri	01.07.2025	Përsëendetje, Nisur nga denoncimi Juaj në lidhje me ndotjen e mjedisit duke sjellë t urbullimin e lumit në zonën e Grykës së Skoranës dhe lumit Erzen nga punimet që kryhe, sqarojme si më poshtë:	E plote	Nuk ka

		lumi eshte bere si kanal ujerash te zeza. Ata zoterinjte se ckan bere atje lart por sapo bie shi shkarkojne gjithë mbeturinat ne lume. Sipas banoreve qe kane qene tek diga keto zoterinj e pastrojne digen per interesat e veta. Nqs ju nuk do merrni masa ju paralaeroj se do te bej denoncim per ndejkje penale me avokat duke filluar nga inspektori me i thjeshte deri tek drejtori pergjithshem ne spak. Po ju dergoj dhe foto si ishte lumi dje, dhe si ka qene para dy vitesh. Keto prova do dergohen dhe ne prokuroi fhe deri ne spak. Pune te mbare		Trupa inspektuese e DIMU pranë IKMT- së kreu inspektimin në terren nga k u rezultoi se: 1. Ishin realizuar punime të pjesëshme për ndërtimin e veprës së marjes së burimit ujqor nga subjekti”AGE Erzen” shpk për të cilën disponon Vendim nga KKT-ja nr.36, dt.16.03.2022, me objekt “Ndërtimi i burimit të ri gjenerues të energjisë, HEC Hekal” me vendodhje Bashkia Tiranë, si dhe Leje Ndërtimi nr.219/6, dt07.04.2023. (Një pjesë e punimeve kanë qënë ekzistuese gjë që e dëshmon dhe Proces Verbali mbi dorëzimin e veprave dhe		
--	--	--	--	--	--	--

				nënveprave të Kanalit Ujitës Skurnë-Hekal, me nr.710/1prot, dt.21.02.2024 mes Drejtorisë së Kullimit dhe Rrugëve Rurale dhe subjektit). 2. Disponon leje për “Përdorim të Burimit Ujorë” nr. prot18/12, dt.08.01.2025 me Vendim të KBU Erzen, nr.16, dt.23.12.2024. 3. Disponon Vendim për VNM Paraprake nga AKM AN150420220005, dt.09.06.2022. Gjatë inspektimit në terren nuk po kryeshin punime dhe rrjedha e lumit ishte e pastër gjë që faktohet dhe nga fotot e bëra në momentin e inspektimit. Kur subjekti do të rifillojë punimet do të monitorohet nga ana jonë në li		
--	--	--	--	---	--	--

				dhje me respektimin e VNM-së paraprake. Bashkëngjitur po ju dërgojmë foto nga inspektimi në zonën e Grykës së Skoranës dhe lumit Erzen, Faleminderit për bashkëpunimin dhe kontributin tuaj në mbrojtjen e mjedisit.		
20	23.06.2025	Përshëndetje Ju lutet shoqërisë suaj për vënie në dispozicion të dokumenteve/informacioneve zyrtare në lidhje me denoncimet publike të bëra nga organizata ndërkombëtare "Blue Heart of Europe" për ndotje të rëndë me mbetje naftë, bitumi apo asfalti pranë kufijve të Parkut Kombëtar	07.07.2025	Përshëndetje Në vijim të kërkesës suaj për informacion me Nr. 20 Rendro, datë 23.06.2025, po ju përcjellim të dhënat e kërkuara në lidhje me veprimet e ndërmarra për ndotje të parkut Kombëtar të Vjosës nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT) gjatë periudhës 2024-2025, si më poshtë:	E plote	Nuk ka

		të Vjosës (Zona mes Gorishtit dhe Selenicës). Më konkretisht: Sipas pamjeve të publikuara në rrjetet sociale dhe verifikimeve në terren, mbetje të rënda naftë dhe asfalti kanë rrjedhur drejt rrjedhës së lumit Vjosa, duke rrezikuar ekosistemin e kësaj zone të mbrojtur. Për këtë kërkoj zyrtarisht informacion mbi veprimet e ndërmarra nga Inspektorati që ju drejtoni. 1. A është kryer ndonjë inspektim mjedisor në stacionin e Gorishtit, në pronësi të kompanisë Alpetrol sh.a., gjatë vitit 2024 ose 2025? Po në zonën e minierës së bitumit në Selenicë? 2. A janë konstatuar shkelje të kushteve mjedisore apo rrjedhje të mbetjeve të naftës, bitumit apo asfaltit drejt rrjedhave ujore që lidhen me lumin Vjosa? 3. A janë marrë masa		A është kryer ndonjë inspektim mjedisor në stacionin e Gorishtit, në pronësi të kompanisë Alpetrol sh.a., gjatë vitit 2024 ose 2025? Po në zonën e minierës së bitumit në Selenicë? Gjatë vitit 2024 - 2025 nuk është kryer asnjë inspektim mjedisor në stacionin e Gorishtit në pronësi të kompanisë "ALB PETROL" sha dhe në zonën e minierës së bitumit në Selenicë. A janë konstatuar shkelje të kushteve mjedisore apo rrjedhje të mbetjeve të naftës, bitumit apo asfaltit drejt rrjedhave ujore që lidhen me lumin Vjosa? Bazuar në urdhërin e punës nr.294, datë 05.06.2025 me nr.2987 prot, datë 05.06.2025 duke marrë shkas nga pamjet e publikuara në media për ndotjen në hidrokarburet të lumit Vjosa, u ngrit grupi i punës	
--	--	---	--	--	--

		administrative, si gjoba, pezullim aktiviteti apo kallëzim penal për këtë subjekt? 4. A është bërë njoftim apo referim tek organet kompetente, si Ministria e Mjedisit apo Prokuroria? 5. Ju lutem, nëse ekzistojnë, më vini në dispozicion kopje të proceseve verbale të inspektimeve apo masave të marra, në përputhje me legjislacionin për të drejtën e informimit. Duke ju falënderuar paraprakisht për bashkëpunimin, mbetem në pritje të përgjigjes suaj!		nga drejtoria e Inspektimit të Mjedisit dhe Ujërave duke u paraqitur në vendndodhjen e ankesës konkretisht në fshatin Gorisht, Vlorë në vendin e quajtur Përroi i Madh Gorisht. Gjatë verifikimit në vend në momentin e mbërritjes në grykëderdhjen pranë lumit Vjosë hasën grupin e punës të përbërë nga punonjësit e shoqërisë “ALB PETROL” sha të cilët po kryenin punimet për rehabilitimin dhe heqjen e materialit hidrokarbur ndër vite pranë shtratit të lumit. Përfaqësuesi i shoqërisë pranë grupit të punës sqaroi se kjo situatë është e akumuluar gjatë një periudhe kohore shfrytëzimi rreth 60 vjet ku nuk ka patur asnjë rehabilitim të shtratit të lumit. Nga verifikimi dhe kontaktet e përfaqësuesit të firmës njofton se nuk ka ndodhur asnjë avari në		
--	--	---	--	--	--	--

				sistemin e depozitimit dhe transmetimit që të shkaktojë rrjedhjen e hidrokarbureve dhe e gjithë kjo situatë ka ndodhur për shkak të temperaturave të larta e cila ka shkaktuar ndryshimin e formës fizike të hidrokarbureve të depozituara ndër vite pranë shtratit të lumit nga të ngurta në të lëngët. Gjithashtu sqarojnë se rehabilitimi do të vazhdojë gjatë gjithë rrjedhës së përroit. Materiali i nxjerrë transportohet në vendin e përcaktuar nga shoqëria ku me sy të lirë në përrua duket sipas raportimeve të mediave kishte hidrokarbure në rrjedhë. Sipas përfaqësuesve pasi të bëhet rehabilitimi i përroit do të vendosen pengesa filtruese. Gjithashtu gjatë verifikimit u konstatua se shoqëria “ALB PETROL” sha po kryente rehabilitimin e plotë të lumit në		
--	--	--	--	--	--	--

				vendin ku ishte shkaktuar ndotja dhe do e vazhdonte në të gjithë sipërfaqen e përroit. A janë marrë masa administrative, si gjoba, pezullim aktiviteti apo kallëzim penal për këtë subjekt? Për këtë subjekt nuk janë marrë masa administrative si gjoba, pezullim aktiviteti apo kallëzim penal. A është bërë njoftim apo referim tek organet kompetente, si Ministria e Mjedisit apo Prokuroria? Jo nuk është bërë njoftim apo referim tek organet kompetente si Ministria e Mjedisit apo Prokuroria. Ju faleminderit!		
21	30.06.2025	Pershendetje	15.07.2025	Përschendetje,	E plote	Nuk ka

	Ju drejtohem me qëllim të shpreh interesin tonë lidhur me një tjetër video të xhiruar nga “Blue Heart Rivers”/Riverwatch" që tregon hapur ndotjen e lumit Vjosa. Ju drejtohem për të kërkuar informacion zyrtar lidhur me ndotjen e rëndë me naftë në një degë të Lumit Vjosa, brenda kufijve të Parkut Kombëtar, sipas raportimeve të fundit nga terreni dhe organizatat mjedisore. Ndaj edhe presim një përgjigje lidhur me pyetjet e mëposhtme: Në këtë kuadër, ju lutem të më vini në dispozicion informacion mbi: A është kryer ndonjë inspektim nga ana juaj në zonën ku është		Në vijim të emailit tuaj, datë 30.06.2025, përmes së cilës kërkon informacion dhe të dhëna lidhur me ndotjen e Lumit Vjosa, ju informojmë sa më poshtë: <i>1- A është kryer ndonjë inspektim nga ana juaj në zonën ku është konstatuar ndotja me substance hidrokarbure?</i> Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit në datë 29.10.2023 ka vijuar me verifikimin e problematikës së shfaqur në lumin Gjanica nga subjekte që ushtrojnë aktivitet (veprimtari) në fushën e nxjerrjes së hidrokarbureve (naftës). <i>2- Nëse po, cilat janë konkluzionet e inspektimit</i>		
--	--	--	--	--	--

		konstatuar ndotja me substanca hidrokarbure? Nëse po, cilat janë konkluzionet e inspektimit dhe a është lëshuar ndonjë masë administrative ndaj subjekteve të përfshira? A është bërë kallëzim penal në lidhje me këtë ndotje, duke qenë se kemi të bëjmë me ndotje brenda një zone të mbrojtur? A është parashikuar një plan monitorimi i përhershëm në atë zonë për të parandaluar ndotje të tjera? Ju faleminderit për kohën dhe bashkëpunimin.		<i>dhe a është lëshuar ndonjë masë administrative ndaj subjekteve të përfshira?</i> Konkluzionet e inspektimit janë relatuar në Memon Nr. 314/9 Prot., datë 26.10.2023, ku është vendosur që çështja të kalojë për trajtim pranë ARM-së, në zbatim të pikës 2 të Urdhrit nr. 29, datë 30.08.2023 “Për zbatimin e ligjshmërisë dhe bashkërendimin në fushën e veprimtarisë inspektuese të mjedisit”, të miratuar nga Inspektorati Qendror. Ky vendim është marrë pasi të dyja subjektet e inspektuara rezultojnë të pajisura me leje mjedisore për ushtrimin e veprimtarisë. <i>3- A është bërë kallzim penal në lidhje me këtë ndotje, duke qenë se kemi të bëjmë</i>		
--	--	---	--	--	--	--

				<i>me ndotje brenda një zone të mbrojtur?</i> Jo sepse verpimet e mëtjeshme verifikuse dhe inspektuese janë kaluar për kompetencë ARM-së. <i>4- A është parashikuar një plan monitorimi i përhershëm në atë zonë për të parandaluar ndotje të tjera?</i> Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit duke marrë shkas nga pamjet e publikuara në media për ndotjen me hidrokarbure të lumit Vjosa, ka ngritur grupin e punës nga Drejtoria e Inspektimit të Mjedisit dhe Ujërave duke u paraqitur në vendodhje konkretisht në fshatin Gorisht, Vlorë në vendin e quajtur Përroi i madh i Gorishtit.		
--	--	--	--	---	--	--

				Nga verifikimi i bërë në terren si dhe kontaktet e marra me përfaqësuesit e firmës njofton se nuk ka ndodhur asnjë avari në sistemin e depozitimit dhe transmetimit që të shkaktojë rrjedhjen e hidrokarbureve. Përfaqësuesit e firmës sqarojnë se e gjithë kjo situatë ka ndodhur për shkak të temperaturave të larta të cilat kanë shkaktuar ndryshimin e formës fizike të hidrokarbureve të depozituara ndër vite pranë shtratit të lumit duke i kthyer nga të ngurta në të lëngëta. Gjithashtu informojnë se rehabilitimi do të vijojë përgjatë gjithë rrjedhës së përroit Gjithashtu IKMT është duke e monitoruar dhe do të vazhdojë monitorimin deri në rehabilitn e plotë të zonës. Duke ju falenderuar,		
--	--	--	--	---	--	--

22	07.07.2025	Përsëhendetje, Ju lutem me vendosni në dispozicion këto informacione: Sa herë janë kryer inspektime nga IKMT gjatë sezonit të fundit për zaptim të paligjshëm të vijës bregdetare dhe plazheve publike? Sa raste shkeljesh janë konstatuar dhe sa masa administrative janë marrë (gjobë, urdhër heqjeje, prishje ndërtimesh)? A mund të na vini në dispozicion një listë të subjekteve ndaj të cilëve janë marrë masa për zaptim të paligjshëm të plazheve? A ka IKMT një plan veprimi për monitorimin dhe lirim të hapësirave publike gjatë sezonit turistik?	22.07.2025	Përsëhendetje, Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, ju bëjmë me dije se gjatë sezonit turistik 2025, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT), në kuadër të Operacionit “Bregdeti Ynë”, ka ndërmarrë veprime konkrete për lirim dhe pastrimin e vijës bregdetare dhe hapësirave publike të zaptuara në mënyrë të paligjshme. Gjatë këtij aksioni janë prishur gjithsej 26 objekte të ndërtuara pa leje gjatë periudhës së gjashtë muorit të parë 2025, në mbështetje të autoriteteve vendore. Ky operacion synon pastrimin e bregdetit dhe territorit nga ndërtimet dhe zaptimet e paligjshme.	E plote	Nuk ka
----	------------	--	------------	---	---------	--------

				Ndërkohë, autoritetet vendore, IKMT dhe Policia e Shtetit po vijnë procesin e identifikimit dhe trajtimit të rasteve të tjera të zaptimit të paligjshëm të hapësirave publike dhe vijës bregdetare, me qëllim garantimin e rendit dhe mbrojtjes së territorit gjatë gjithë sezonit turistik.		
23	15.07.2025	Përsëndetje, Kërkojmë të informohemi, për sa më poshtë. 1.A ka kryer IKMT kontrolle për ndërtimet pa leje në zonën e Thethit në 5 vitet e fundit? Nëse po, sa kontrolle janë bërë dhe çfarë kanë konstatuar? 2. Sa objekte pa leje janë identifikuar nga IKMT në Theth		Përsëndetje, Në lidhje me kërkesën tuaj për informacion, ju bëjmë me dije se: Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT), në ushtrim të detyrave dhe përgjegjësi të përcaktuara në ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, i ndryshuar, gjatë periudhës 2020–2025, ka ushtruar veprimtari inspektuese në	E plote	Nuk ka

	gjatë vitit të fundit? A ka një statistikë zyrtare? 3. Sa objekte janë shembur nga IKMT në këtë zonë dhe sa janë legalizuar pas ndërtimit pa leje? 4. Cilat janë sfidat që përballen IKMT në ndërhyrjen në zonat e mbrojtura si Thethi, që janë edhe pjesë e Parkut Kombëtar? 5. Sa procedura gjyqësore janë hapur nga IKMT për ndërtimet pa leje në Theth? A ka ndonjë rast të veçuar që mund të bëhet publik? 7. A ka ndërtime që ndodhen brenda kufijve të zonës së mbrojtur (Park Kombëtar i Thethit), dhe nëse po, çfarë masash janë marrë për to? 8. Cilat institucione të tjera janë të përfshira në kontrollin e	fshatin Theth, ku janë inspektuar dhe janë ndjekur procedura administrative për rreth 13 (trembëdhjetë) objekte të ndërtuara në kundërshtim me legjislacionin në fuqi. Në përgjigje të pikave 2, 3 dhe 9 të kërkesës suaj, sqarojmë se IKMT ka ndërmarrë masa për ekzekutimin e rreth 128 (njëqind e njëzet e tetë) objekteve, ku një pjesë e vendimeve për prishje janë marrë nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit pranë Bashkisë Shkodër dhe janë ekzekutuar nga IKMT, në përputhje me kompetencat ligjore. Referuar pikes 4. Një nga sfidat e IKMT-së është dhe ndërgjegjësimi i banorëve/ subjekteve, për të mos kryer ndërtime pa leje. Në përgjigje të pikës 7 të kërkesës suaj, sqarojmë se vendimet e cituara	
--	--	---	--

	territorit në Theth, përveç IKMT? A funksionon bashkëpunimi institucional? 9. Sa kontrole janë bërë në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër apo Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM)? 10. A ka ndonjë hetim të brendshëm apo hetim nga organet e drejtësisë për tolerime të mundshme nga zyrtarë lokalë ndaj ndërtimeve pa leje në Theth? 11. Cili është plani i IKMT për vitin 2025 për zonën e Thethit? A ka ndonjë aksion të parashikuar për sezonin turistik apo pas tij? Për çdo komunikim tjetër me qëllim orientimin dhe sqarimin e paqartësive, mund të më		janë marrë për objekte të evidentuara brenda kufijve të zonës së mbrojtur, konkretisht Parkut Kombëtar të Thethit. Referuar pikës 8 të kërkesës suaj, kontrolli i territorit në zonën e Thethit, e cila bën pjesë në Parkun Kombëtar, realizohet përmes një mekanizmi të koordinuar ndërinstitutional, ku, përveç Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT), përfshihen edhe institucione të tjera me kompetenca të posaçme ligjore, si Bashkia Shkodër, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM) dhe Policia e Shtetit. IKMT ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me ligjin nr. 9780/2007, i ndryshuar, me qëllim sigurimin e respektimit të normave, standardeve dhe kushteve zhvillimore, si dhe		
--	--	--	---	--	--

		kontaktoni edhe në kontaktet e mëposhtme. Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,		mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme, në bazë të ndarjes administrative dhe kompetencave ligjore. Faleminderit.		
24	13.07.2025	Pershendetje, Në bazë të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, kërkojmë informacionin e mëposhtëm lidhur me aksionin e demolimit të ndërtimeve të paligjshme në zonën e Thethit: 1 – Një kopje të të 80 Procesverbaleve për konstatimin e kundërvajtjes së ndërtimit pa leje nga subjektet në zonën e Thethit – dokument i detyrueshëm që pasqyron masat e konstatuara nga inspektori;	08.08.2025	I nderuar , Në vijim të kërkesës suaj për informacion, dhe në zbatim të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ju informojmë në lidhje me pyetjet e drejtura Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT), si më poshtë: – A ka parashikuar IKMT lëshimin e procesverbaleve për konstatimin e shpenzimeve të prishjes për demolimin e këtyre objekteve? Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT), si institucion qendror përgjegjës për ndjekjen dhe	E plote	Nuk ka

		2 – Një të të 80 Vendimeve për gjobë për këto ndërtime strukture të paligjshme (nëse ka); 3 – Një kopje të të 80 Vendimeve për prishjen e objektit të kundërligjshëm; 4 – A ka parashikuar IKMT lëshimin e Proces-verbaleve për konstatimin e shpenzimeve të prishjes për demilimin e këtyre objekteve? Nëse po, kërkoj të më vihet në dispozicion një kopje. 5 – A ka parashikuar IKMT lëshimin e Vendimeve për zhdëmtimin e shpenzimeve të prishjes?		zbatimin e legjislacionit në fushën e mbrojtjes së territorit në nivel kombëtar, ju bën me dije se, në lidhje me aksionin e ndërmarrë për prishjen e ndërtimeve të paligjshme në zonën e Thethit, ka vepruar në mbështetje të strukturave vendore. – A ka parashikuar IKMT lëshimin e vendimeve për zhdëmtimin e shpenzimeve të prishjes? Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT) nuk ka parashikuar dhe nuk ka lëshuar vendime për zhdëmtimin e shpenzimeve të prishjes, pasi kjo procedurë i përket Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit (IMT) Bashkia Shkodër. Ju faleminderit.		
--	--	--	--	--	--	--

25	15.07.2025	Pershendetje, Prej disa ditësh në Parkun Kombëtar të Thethit kanë nisur shembjet e godinave paleje. A keni hartuar një plan masash evidentimin e rasteve ku duhet të kryhen shembjet e godinave ne zonën e Thethit? Nëse po, ju lutem na e vendosni në dispozicion? Ju lutem na vendosni në dipozicion raportin ku saktësohet nëvoja, dhe mënyra se cilat janë ndërhyrjet e parashikuara prej jush në zonën e Thethit? Sa kanë qenë sinjalizimet e marra nga banorët e thethit për ndërtime paleje në këtë zonë gjatë vitit 2023/ 2024 dhe janar-korrik 2025?	Adresa e e-mailit jo aktive	Përshendetje, Në vijim të kërkesës suaj për informacion, ju bëjmë me dije sa më poshtë: Në lidhje me ndërhyrjet e kryera në zonën e Thethit, Bashkia Shkodër informon se veprimet janë realizuar në mbështetje të vendimeve të marra nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit (IMT) pranë Bashkisë Shkodër dhe në përputhje me Ligjin Nr. 9780/2007, i ndryshuar. Për më shumë informacion mbi veprimet e kryera,mund ti dejtoheni Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit pranë Bashkisë Shkodër. Faleminderit.	E plote	Nuk ka
----	------------	--	-----------------------------	--	---------	--------

		Duke ju falenderuar paraprakisht për bashkëpunimin, mbetem në pritje të përgjigjes suaj!				
26	15.07.2025	Përsëndetje, Unë jam një shqiptar që jetoj jashtë vendit, por me rrënjë nga Thethi. Po ju shkruaj me shumë respekt për të ndarë një shqetësim që kam unë vetë, por edhe shumë turistë që vizitojnë zonën. Kohët e fundit, në rrugën që të çon drejt Grunasit dhe ujëvarës, para se të kalohet lumi, disa ndërtimtarë kanë ngritur struktura të improvizuara dhe ndryshime të paplanifikuara në rrugë, të cilat bllokojnë kalimin normal dhe e bëjnë më të vështirë qasjen për këmbësorët dhe vizitorët. Këto ndërhyrje jo vetëm që pengojnë qarkullimin, por krijojnë edhe	18.07.2025	I nderuar , Në përgjigje të ankesës suaj, ju bëjmë me dije se, në datën 16.07.2025, Inspektorët e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit pranë Bashkisë Shkodër kanë kryer verifikime në terren dhe kanë kryer katër procesverbale konstatimi për objekte të ndërtuara në mënyrë të paligjshme në zonën e Grunasit. Faleminderit për bashkëpunimin,	E plote	Nuk ka

		pakënaqësi për turistët, të cilët shpesh ankohen që nuk ka qartësi ku kalon rruga dhe si mund të shkohet drejt ujëvarës apo kanionit. Edhe unë, sa herë kaloj aty me miq, familjarë apo turistë që shoqëroj, shoh se rruga shpesh ngushtohet nga struktura të shtuara që nuk janë të organizuara mirë dhe nuk respektojnë natyrën e zonës. Për më tepër, këto ndërhyrje të paorganizuara japin një përshtypje jo të mirë për imazhin e Thethit si destinacion natyror i mbrojtur. Nuk dua të hyj në emra biznesesh apo individësh, pasi e di që situata është delikate, por me shumë respekt ju kërkoj të vlerësoni këtë problem dhe të gjeni një zgjidhje që ruan qasjen e lirë, respektimin e rrugës				
--	--	---	--	--	--	--

		tradicionale dhe mbrojtjen e natyrës. Besoj që Bashkia dhe IKMT mund të bashkëpunojnë për të rregulluar këtë pjesë dhe të sigurojnë që vizitorët të kenë mundësinë të lëvizin lirshëm, pa pengesa artificiale. Ju faleminderit për mirëkuptimin dhe për çdo veprim që do të ndërmerreni për të ruajtur bukurinë dhe qasjen e lirë në këtë zonë të mrekullueshme. Me respect				
27	17.07.2025	Përshëndetje, Deshiroj të njihem me praktiken e plote ligjore e dokumentare të shembjes së ndertesave dhe		Përshëndetje, Në lidhje me kërkesën tuaj për informacion, ju bëjmë me dije se ndërhyrjet e kryera në zonën e Thethit, Bashkia Shkodër, janë	E plote	Nuk ka

		objekteve nga IKMT Shkoder ne Theth gjate muajit korrik 2025. Me specifikisht, ju lutem te: - listoni emrat e banoreve qe pretendohet se kane kryer paligjshmeri dhe te qarteson nese ata jane posedues jopronare te tokes ku objekti eshte ndertuar; - te dergoni relacione/raporte te brendshme ne lidhje me konstatimet e paligjshmerive te pretenduara; - te dergoni gjurme dokumentare te njoftimit te banoreve mbi shembjet sipas percaktimeve ligjore ne fuqi;		realizuar në mbështetje të vendimeve të marra nga IMT e Bashkisë Shkodër dhe në përputhje me Ligjin Nr. 9780/2007, i ndryshuar. Sa i përket kërkesës suaj për informacion mbi emrat e banorëve, raportet e brendshme dhe urdhrat e firmosur, ju lutemi t’i drejtoheni drejtpërdrejt IMT-së së Bashkisë Shkodër. Faleminderit.		
--	--	---	--	--	--	--

		- te dergoni urdhrat e firmosur nga institucioni per shembjen e objekteve, te cilet duhet te permbajne bazen ligjore mbi te cilen jane marr vendimet.				
28	18.07.2025	Përshëndetje, Në sa raste ka ndërhyrë Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit për ndërtime të paligjshme në zonën e Thethit në Shkodër në pesë vitet e fundit. Specifikoni për secilin vit? Cilat janë autorizimet ligjore dhe administrative për ndërhyrjet që janë bërë në zonën e Thethit?		Përshëndetje, Në lidhje me kërkesën tuaj për informacion, ju bëjmë me dije se: Fillimisht theksojmë se ndërhyrjet e kryera në zonën e Thethit, Bashkia Shkodër, janë realizuar në mbështetje të vendimeve të marra nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit (IMT) i Bashkisë Shkodër dhe në përputhje me Ligjin Nr. 9780, datë 16.07.2007, i ndryshuar. Gjatë periudhës 2020–2025, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT) ka ushtruar veprimtari inspektuese në fshatin Theth, ku janë inspektuar dhe janë ndjekur procedura administrative për rreth 13 objekte të ndërtuara në	E plote	Nuk ka

	A janë respektuar kufizimet mjedisore dhe zonat e mbrojtura gjatë këtyre ndërhyrjeve? Çfarë lloj ndërhyrjesh janë kryer (ndërtimore, infrastrukturore, rrugë, turizëm etj.) dhe cili është ndikimi i tyre në peizazhin natyror? A ka pasur raste të shkeljeve të ligjit për ndërtimin në zonën e Thethit dhe si janë trajtuar ato? Cili është ndikimi i ndërhyrjeve në ekosistemin lokal, përfshirë florën dhe faunën e zonës? A janë marrë masa për konsultim dhe përfshirje të komunitetit lokal në procesin e planifikimit dhe zbatimit të këtyre ndërhyrjeve? Si po monitorohen dhe inspektohen ndërhyrjet për të	kundërshtim me legjislacionin në fuqi. Për sa i përket ndërhyrjeve të kryera, kryesisht gjatë muajit korrik, kanë përfshirë prishjen e objekteve të ndërtuara pa leje, pa ndërhyrje të tjera infrastrukturore që mund të dëmtonin peizazhin natyror. Të gjitha veprimet janë kryer duke respektuar zonat e mbrojtura, duke minimizuar ndikimin në florën, faunën dhe ekosistemin lokal. Çdo shkelje e konstatuar është trajtuar sipas procedurave ligjore, duke përfshirë informimin. Për informacion të mëtejshëm lidhur me rastet konkrete, statistikatat e ndërhyrjeve sipas viteve, apo detaje të tjera administrative, ju mund të kontaktoni IMT-në e Bashkisë Shkodër. Faleminderit.		
--	---	--	--	--

		siguruar respektimin e normave ligjore? A ka pasur raste korrupsioni apo keqpërdorimi të fondeve gjatë realizimit të këtyre ndërhyrjeve? Çfarë masash parandaluese apo riparimit janë ndërmarrë për të minimizuar dëmet e mundshme në territor? Si i përgjigjet Inspektorati denoncimeve apo shqetësimeve nga qytetarët apo organizatat mjedisore lidhur me ndërhyrjet në Theth? Ndërtimet e bëra vitet e fundit kanë qenë brenda zonës së mbrojtur?				
29	18.07.2025	Përsëndetje, Duke u mbështetur në Ligjin Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit," dhe në përputhje me	21.07.2025	Përsëndetje. Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, ju bëjmë me dije se: Drejtoria e Inspektimit të Mjedisit	E plote	Nuk ka

		nenet e këtij ligji, i cili rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike, ju drejtohem me këtë kërkesë për të marrë informacionin e mëposhtëm lidhur me inspektimet që ka kryer institucioni juaj nga data 1 Janar 2020 deri më datë 18 Korrik 2025, në fabrikën e pasurimit të bakrit, Beralb sh.a në Fushë-Arrëz: 1. Sa inspektime janë kryer? 2. Cilat kanë qenë objektet e inspektimit? 3. Sa inspektime keni kryer për shkak të ndotjes që shkakton aktiviteti i kësaj kompanie në ujin e lumit Fan?	dhe Ujërave pranë IKMT-së, e ka ndjekur problematikën e cituar shumë më parë, duke ndërmarrë veprime konkrete kundrejt subjektit BERALB shpk. Konkretisht kjo drejtori ka kryer një inspektim të thelluar në Janar të vitit 2024, dhe në përfundim të inspektimit ka dalë me një vendim përfundimtar inspektimi i cili përmban dy masa administrative, e më konkretisht: Masë administrative në lekë prej një totali prej 10.000.000 lekë të reja. Masë administrative plotësuese pezullimi i menjëhershëm i aktivitetit të fabrikës së përpunimit të bakrit, me afat deri në marrjen e masave konkrete dhe urgjente për instalimin dhe vendosjen e infrastrukturës së duhur që do të		
--	--	---	---	--	--

		4. A keni konstatuar shkelje dhe ndotje mjedisore dhe a keni marrë masa dhe cilat janë ato? Nëse po, lutemi të na vendosni në dispozicion dokumentet përkatëse dhe raportet nga inspektimet në terren.		bëjë paramandalimin e shkarkimeve të ndotura në lumin Fan. Edhe pas ankimimit të bërë nga ky subjekt, komisioni i shqyrtimit të ankimeve administrative në IKMT, ka lënë në fuqi vendimin përfundimtar të trupës inspektuese. Pas ezaurimit të këtyre procedurave subjekti BERALB shpk, ka arritur të sigurojë një masë siguri padie në gjykatën administrative, (kopje të së cilës gjeni bashkëlidhur) dhe aktualisht çështja midis IKMT-së dhe Subjektit “BERALB shpk” është në shqyrtim në themel në Gjykatën e Shkallës së Parë Administrative. Bashkalidhur gjeni dokumentacionin e mbajtur nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit për subjektin e		
--	--	--	--	--	--	--

				sipërcituar si dhe vendimet e KSHAA-së (Komisioni i Shqyrtimit të Ankimeve Administrative). Duke ju falenderuar,		
30	18.07.2025	Siç e shikoni ne si Komunitet kemi vuajtur shume nga djegia e plehrave prane ujit te pijshem qe eshte 700metra larg ku ne hyrje thote Parku Kombetar Bredhi Hotove por dhe Lumi Vjose u shpall park kombetar me deget e saj . Ne I jemi drejtuar KLSH, ku si auditim kapi shume shkelje, qe nga certifikata, degjese publike, leje mjedisore etj,, kemi protestuar ne media TV, jugu lajm, report tv, mcn tv emisioni Fol, a2cnn,syri tv ,emisioni veting news 24 etj,,kemi	27.07.2025	Pershendetje, Bashkalidhur do te gjeni praktiken nga Inspektorati Kombetar i Mbrojtjes se Territorit. Faleminderit	E plote	Nuk ka

		protestuar por deri me tani nuk kemi arritur gjera konkrete nga ana e institucionit Bashkia Permet qofte edhe nje falje ndaj Komunitetit por ne dhjetor te 2024 qe e ftuam neve si Komunitet ja bente qe e ve zjarrin 1banor I fshatit Piskove por kur ju kthye fshati Kryetarja e bashkise permet u terhoq dhe nxirrte justifikime qe skemi fonde ti mbulojme plehrat me dheun persiper ku projekti e parashikonte qe te sheshoheshin me rul, pastaj me dheun persiper, ku ne cdo shkrese qe u kane kthyer pergjigje institucionit te avokatit te popullit, Prefekti Qarkut Gjirokaster, thone qe ai Landifill eshte brenda kushteve ku ne realitet eshte ndryshe por dhe policia permet nuk kemi pare hapa konkrete per fajtoret qe				
--	--	--	--	--	--	--

		bejne ate gje dhe shprehen qe I kemi hetime sekreti. Do te them qe aty I eshte vene mbi 6here zjarr madhor, plus djegia e vazhdueshme qe I digjnin avash avash por dhe siç e shikoni ne foto dhe video ca do makina e nenkryetarit te bashkise permet ,Zjarrfikesja, kamioni privat qe sjell skavatorin qe te hedhin plehrat ne Landifill dhe ne momentin qe ato plehra qe digjeshin Zjarrfikesja eshte per ta shuajtur per te mos patur tym te madh ne gjykimin tim,,. Ne jemi te pambrojtur si Komunitet por cdo institucion shteteror ka te drejten t'u siguroj jete ekologjike te paster te brezave te sotem e ne vazhdim per te punuar e ndertuar ne token e te pareve dhe siç e ka kushtetuta e vendit tone .				
--	--	--	--	--	--	--

		Na ndihmoni para se te jete teper vone pasi kemi pasur kohet e fundit njerez me semundje te lige ku mund ti vertetoni te Qsut Tirane, ku 2veta kane nderuar jete, keto mund ti degjoni nga goja e banoreve qe jane shprehur te emisioni Fol me Erjon Skendaj . Une do u dergoj foto dhe video ku ju si institucion ti gjykoni dhe shqyrtoni me mire nga ana ligjore me eksperte qe ka ai institucion,ku ai landfill ka 2grykederdhje; lumicen dhe Hotoven,. Na ndihmoni qe te mos egzistoj me ai Landifill para se te jete teper vone. Bashkangjitur keni dhe firmat e banoreve.				
--	--	---	--	--	--	--

31	21.07.2025	Përshëndetje, Ne rrugen Fan Noli ne Kamez.... eshte zaptuar bregu i Lumit Tirana me inerte edhe ka filluar ndertimi ne breg te Lumit..... nje zaptim i nje sipërfaqe te madhe toke edhe nje magazine e madhe buze Lumit.... zona sipas planit rregullues te Bashkise Kamez eshte zone e gjelbert edhe eshte e ndaluar ndertimi....	Përshëndetje. Bazuar në Urdhërin e Punës, Nr.350, datë 30.06.2025, lëshuar nga Kryeinspektori IKMT-së, një grup pune i DMIU-së më datë 16.07.2025, ka kryer një kontroll për verifikimin e një ankese, protokolluar në IKMT, me Nr.3554 prot, me datë 15.07.2025, nga shtetasi XXXXXXXX, me objekt “Ankesë për një gurore buzë lumit Tërkuzë”. Pranë ambjenteve të indikuara trupa inspektuese ka konstatuar se aty operonte subjekti “Thurje” SHPK me NIPT: M1132009B, subjekti i cili dispononte leje mjedisi tipi “B”. Në zbatim të Urdhërit Nr.374 dhe 374/1, datë 30.08.2023 të Inspekratit Qëndror, i dërgohet për kompetencë Agjencis Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër.	E plote (adresa e eamilit e caktivizuar)	
----	------------	---	--	--	--

32	29.07.2025	Mbështetur në legjislacionin e posaçëm mbi të cilin operon IKMT, qëllimi i të cilit është respektimi i normave dhe standardeve dhe i kushteve zhvillimore në fushën e zhvillimit të territorit dhe të burimeve ujore në të gjithë vendin, si dhe mbështetur në detyrat dhe përgjegjësitë e IKMT, të tilla si: hartimi i planeve vjetore të inspektimit, kryerja e inspektimeve dhe operimi administrativ në nivel vendor, kërkojmë si vijon,	12.08.2025	Përhëndetje, Në vijim të kërkesës suaj për informacion me Nr. 32 Rendor, datë 29/07/2025, ju përcjellim të dhënat e kërkuara si më poshtë: A janë inspektuar rrjedhat ujore dhe konkretisht, në respekt të prurjes ekologjike të lejuar gjatë operimit të impianteve të prodhimit të energjisë elektrike nga burime hidrike? Nëse po, cilat kanë qënë (impiantete)? A është konstatuar mosrespektim i sasisë së prurjes ekologjike nga kompanitë që operojnë impiantet në fjalë gjatë operimit? Si paraqitet situata në dhjetë vitet e fundit? Drejtoria e Inspektimeve në Mjedis dhe Ujëra, pranë IKMT-së, që nga	E plote	Nuk ka

	1. A janë inspektuar rrjedhat ujore dhe konkretisht, në respekt të prurjes ekologjike të lejuar gjatë operimit të impianteve të prodhimit të energjisë elektrike nga burime hidrike? Nëse po, cilat kanë qënë (impiantete)? A është konstatuar mosrespektim i sasisë së prurjes ekologjike nga kompanitë që operojnë impiantet në fjalë gjatë operimit? Si paraqitet situata në dhjetë vitet e fundit? 2. A keni pasur ndonjë ankesë nga qytetarë, apo përfaqësues të tyre, që të kenë kërkuar inspektimin apo që të kenë denoncuar mosrespektimin, e prurjes		momenti i marrjes së aksesit në sistemin online <i>e-inspektimi</i> (viti 2022), ka përfshirë në programet e saj të punës, vjetore dhe mujore, inspektimet në subjektet që ushtrojnë aktivitetin e prodhimit të energjisë së rinovueshme, duke shfrytëzuar burimet ujore natyrore sipërfaqësore. Informacioni i disponueshëm i përket një periudhe 3.5-vjeçare. Gjatë kësaj periudhe kjo drejtori ka kryer inspektime në HEC-e që operojnë nga veriu e deri në jug të vendit, inspektimet kanë qënë të programuara ndërkohë që të paprogramuarat kanë pasur si indicie kryesisht ankesat e ardhura nga përfaqësit e komuniteteve ku po ndërtohen apo janë ndërtuar këto HEC-e si dhe informacionet e ardhura nga ente të tjera relevante, kryesisht organet e menaxhimit të		
--	--	--	---	--	--

		ekologjike? Nëse po, si është proceduar dhe cilat kanë qënë rezultatet e arritura gjatë inspektimit për të njëjtën periudhë. 3. A keni inspektuar impiante të prodhimit të energjisë elektrike nga burime hidrike (HEC-e) gjatë dhjetë viteve të fundit? A keni marrë masa administrative; keni vendosur ndonjë gjovë ndaj tyre? Nëse po, në cilat HEC-e dhe për cila ka qënë shkelja?		burimeve ujore (AMBU, KBU, KBU, etj). Sa i përket konstatimeve të bëra, rezulton se në një numër të caktuar impiantesh ka patur mangësi në zbatim të legjislacionit përkatës (Ligji Nr.29, datë 23.04.2024, neni 133, Kontrolli administrativ i përdorimit të burimeve ujore). A keni pasur ndonjë ankesë nga qytetarë, apo përfaqësues të tyre, që të kenë kërkuar inspektimin apo që të kenë denoncuar mosrespektimin, e prurjes ekologjike? Nëse po, si është proceduar dhe cilat kanë qënë rezultatet e arritura gjatë inspektimit për të njëjtën periudhë. Po, përgjatë kësaj periudhe (3,5-vjeçare), Drejtoria e Inspektimeve në Mjedis dhe Ujëra, pranë IKMT-së, ka kryer inspektime duke marrë shkas nga ankesat e ardhura dhe, në	
--	--	---	--	--	--

				ato subjekte/aktivitete ku ka konstatuar shkelje të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e mjedisit dhe atij të posaçëm për burimet ujore, ka marrë masat administrative përkatëse që përkojnë me gjoba financiare dhe pezullime aktiviteti deri në rikthimin e rrjedhës së lirë ekologjike. A keni inspektuar impiante të prodhimit të energjisë elektrike nga burime hidrike (HEC-e) gjatë dhjetë viteve të fundit? A keni marrë masa administrative; keni vendosur ndonjë gjovë ndaj tyre? Nëse po, në cilat HEC-e dhe për cila ka qënë shkelja? Po, nga viti 2022 deri në korrik të vitit 2025, DIMU, pranë IKMT-së, ka kryer inspektime në impiante të prodhimit të energjisë elektrike nga burime hidrike (HEC-e) dhe, në		
--	--	--	--	--	--	--

				shumë raste ku ka konstatuar shkelje administrative, ka marrë masa me gjoba dhe pezullime. Kryesisht, shkeljet kanë pasur të bëjnë me moslejimin e rrjedhës së lirë ekologjike dhe mosrinovimin e lejes së përdorimit të burimit ujqor. Sa i përket informacionit se në cilat HEC-e, aktualisht është teknikisht e pamundur dhënia e informacionit për shkak të bllokimit momental të sistemit unik e-inspektimi, si pasojë e riformatimit me bazën e re ligjore. Faleminderit,		
33	31.07.2025	Përshtëndetje, Duke u mbështetur në Ligjin Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit," dhe në përputhje me nenet e këtij ligji, i cili rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose	08.09.2025	Përshtëndetje, Bashkëngjitur po ju dërgojmë përgjigjen nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit. Faleminderit	E plote	Nuk ka

		mbahet nga autoritetet publike, ju drejtohem me këtë kërkesë, lidhur me fillimin e punimeve të një objekti të kundraligjshëm në zonën Kune - Vain - Tale, e cila është zonë Rezervat Natyror i Menaxhuar, Park Natyror, Kategoria e IV-t (IUCN). Shpallur me VKMnr.432, datë 28.04.2010, për të marrë informacionin e mëposhtëm: 1. A janë kryer inspektime në këtë territor? 2. A keni konstatuar shkelje, mbushje të terrenit, prerje të pemevë, breza betoni për të hapur shesh ndërtimi dhe ndotje mjedisore dhe a keni marrë masa? Nëse po, lutemi të na vendosni në dispozicion raportet nga				
--	--	--	--	--	--	--

		inspektimet në terren. Bazuar në detyrimet ligjore për transparencë dhe në të drejtën e qytetarëve për t'u informuar, presim që të na mundësoni informacionin e kërkuar brenda afatit të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi. Duke ju falënderuar paraprakisht për bashkëpunimin, mbetemi në pritje të një përgjigjeje sa më të shpejtë nga ana Juaj.				
34	05.08.2025	Pershendetje, Konkretisht, kërkojmë informacion për kompaninë "Babasi Co" sh.p.k. – ose nënkontraktorë të saj që mund të jenë duke operuar në të njëjtën zonë – si më poshtë:	30.09.2025	Pershendetje, Në vijim të kërkesës suaj, drejtuar Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, me numër rendor 34, në lidhje me kompaninë "Babasi Co" shpk, ju bëjmë me dije se Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT) ka kryer dy (2) inspektime ndaj subjektit "Babasi	E plote	Nuk ka

		1. A ka kjo kompani një leje mjedisore aktive për zhvillimin e aktivitetit të gurores në zonën në fjalë? 2. Nëse jo, ju lutem konfirmoni: A është pezulluar apo revokuar leja mjedisore e kësaj kompanie? Datën dhe vendimin zyrtar të pezullimit apo revokimit (numër protokolli, institucion vendimarrës). 3. Arsyet e pezullimit/revokimit (nëse ka ndodhur). 4. A është konstatuar nga inspektorët e mbrojtjes së mjedisit apo një organ tjetër mbikëqyrës se kompania apo kontraktorë të saj po vijnë në zonë pavarësisht mungesës së lejes? 5. A janë marrë masa ndëshkimore për rast të ushtrimit të aktivitetit në kundërshtim me		Coo" shpk, në vitin 2022 dhe vitin 2024. Në inspektimin e parë, atë të vitit 2022, janë konstatuar shkelje të kushteve të lejes mjedisore dhe është vendosur masa administrative prej 300.000 lekësh (të reja), e ekzekutuar nga përmbaruesi. Ndërsa në inspektimin e dytë, atë të vitit 2024, është konstatuar përsëri shkelje të kushteve të lejes mjedisore, por kësaj here nuk u morën veprime të mëtejshme procedurale për shkak të një urdhri të lëshuar nga Inspektorati Qendror (Kryeinspektori z. Shkëlqim Hajdari), lëshuar më datë 30.08.2023, Nr. 374 dhe 374/1, pika 3, përcjellë me shkresën Nr. 368/2, ku urdhërohej IKMT-ja që në të tilla raste të ndërpriste ushtrimin e detyrave duke ia kaluar	
--	--	--	--	--	--

		legjislacionin mjedisor në këtë zonë? Duke ju falënderuar paraprakisht për bashkëpunimin, mbetem në pritje të përgjigjes suaj! Për çdo komunikim tjetër me qëllim orientimin dhe sqarimin e paqartësive, mund të më kontaktoni edhe në numrat apo adresën elektronike të poshtëshënuar		për kompetencë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM) dhe duke njoftuar Inspektoratin Qendror (IQ). Për këtë arsye, më datë 15.01.2024, sipas urdhrit të punës Nr. 43, datë 15.01.2024, pasi kanë kryer verifikimet në terren, kanë mbajtur një Akt-Konstatimi, në prani të përfaqësuesit ligjor të shoqërisë, ku ka cituar/njoftuar subjektin se vijimi i procedurave të mëtejshme do t'i njoftohet për kompetencë/ndjekje dhe zbatim AKM-së dhe IQ-së. Sjellim në vëmendjen tuaj se praktika e ndjekur nga ana e IKMT-së ka qenë efekt edhe i një auditimi nga ana e KLSH-së, praktikë e cila në projekt-raportin e KLSH-së Gusht-2025, është cilësuar e		
--	--	---	--	--	--	--

				rregullt dhe në zbatim të legjislacionit/urdhrave të lëshuara. (Projekt-Raporti i KLSH-së, dërguar në IKMT më datë 08.08.2025 dhe protokolluar në IKMT me Nr. 2412/5 Prot, datë 11.08.2025). Faleminderit.		
35	06.08.2025	Përshëndetje, Referuar aksit të fundit të bërë publik nga kryeministri i vendit për marrjen e masave të pastrimit dhe lirimit të hapësirave publike në anë të akseve kombëtare, nga institucionet e ngarkuara për këtë nisme, kërkoj informacion lidhur veprimet e ndërmarra në aksin kombëtar Rrethrotullimi	08.09.2025	I nderuar, Në lidhje me kërkesën tuaj për informacion mbi ndërhyrjet në aksin kombëtar Rrethrotullimi TEG – Ura e Farkës – Baldushk – Mustafakoçaj, ju bëjmë me dije se Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit është akoma në proces inspektimi në të gjitha akset kombëtare, në përputhje me Urdhërin Nr. 392, datë 25.07.2025 “Për inspektim të objekteve/ndërhyrjeve që cënojnë	E plote	Nuk ka

	TEG - Ura e Farkës – Baldushk – Mustafakoçaj. Duke parë se aktualisht nuk ka ndërhyrje në këtë aks rrugor, kërkoj informacionin e mëposhtëm: 1. A janë bërë inspektime dhe evidentime të përgjithshme në terren nga institucionet tuaja lidhur me këtë aks? Nëse po, çfarë është identifikuar dhe çfarë ndërhyrjesh janë planifikuar? 2. Kur do të ndërhyjnë institucionet përkatëse në lirim dhe pastrimin e hapësirave publike në anë të rrugës? Shtojmë këtu se ky aks rrugor, në të gjithë perimetrin e tij, ka shumë mangësi në elementë të sigurisë rrugore		sigurinë përgjatë akseve rrugore kombëtare”. Në rast se dispononi informacion për një subjekt apo objekt, ju lutem mund t’i drejtoheni emailit info@ikmt.gov.al me detajet përkatëse, në mënyrë që të trajtohet sipas procedurave të institucionit. Ju faleminderit për bashkëpunimin.		
--	--	--	---	--	--

		sidomos për shkak të ndërhyrjeve të palejuara, dëmtime/heqje të gardheve mbrojtës metalike anësore, depozitime dherash pa leje, prishje të mureve mbajtës të rrugës, përdorim të saj për parkingje të paligjshme nga subjektet në anë të rrugës, etj. Kjo për shkak të papërgjegjshmërisë së nënkontraktorëve dhe kompanive të mirëmbajtjes së rrugës, të cilët prej vitesh nuk i kanë përmbushur detyrimet e tyre.				
36	01.08.2025	Përshkrimi i problemit: Përmes këtij denoncimi, dua të sjell në vëmendjen tuaj një ndërtesë e cila ndodhet shumë pranë autostradës Durrës-Tiranë (SH2), në zonën Shkozet ,	08.08.2025	Pershendetje! Ne lidhje me ankesen percjell nga ju nepermejt emailt te meposhtem ju bejeme me dije se:	E plote	Nuk ka

		përballë mbikalimit të rrugës “Marin Barleti”. Objekti ndodhet ngjitur me Autostraden SH2 dhe sipas vlerësimit vizual, distanca e tij nga rruga kryesore është shumë e vogël – ndoshta më pak se 10 metra. Kjo ndërtesë, subjektit "Gomisteri Auto Eno", ngre dyshime të forta për shkelje të ligjeve urbanistike dhe rrugore, pasi ndërtimet pranë rrugëve nacionale si SH2 duhet të respektojnë distancën ligjore minimale. Ju lutem të verifikoni nëse kjo ndërtesë: • Ka leje ndërtimi të rregullt nga Bashkia Durrës, • Ka marrë miratim nga Autoriteti Rrugor		Nga trupa inspektuese e IKMT është kryer ne kuader te aksionit per respektimin e parametrave te sigurise rrugore ndermarre nga IKMT dhe ARRSh, eshte konsattuar se subjekti gomisteri Auto Eno TD, ka sjkelje te parametrave te sigurise rrugore ne lidhje me vendosjen e gomave ne distance jo te duhur nga aksi i ruges sipas parametrave te percaktuara nga Kodi Rrugore. Ne keto kushte i eshte mbajtur AKT Konstatimi, si per te gjitha sbjektet e tjera per marrjen e masave per zhvendosjen e materialeve (gomave) ne distancen e kerkuar brenda dates 31.07.2025. Ne momentine riinspektimit rezulton se subjekti ka marre masa duke pastruar ambjetin dhe larguar gomat ne distancen e kerkuar.		
--	--	--	--	--	--	--

		Shqiptar (ARRSH) për ndërtim pranë autostradës, • Respekton distancat e përcaktuara me ligj për ndërtimet pranë rrugëve nacionale, • Është pjesë e ndonjë plani rregullues të miratuar. Ju lutem të ndërmerrni hetimet dhe masat e nevojshme, sipas ligjit, nëse konstatohet shkelje.		Sa i perket kërkeses nese objekti ka leje nderitmit, ju bejme me dije se ne objekt aktualisht nuk pop kryehen punime ndertimi qe kerkojne paisjen me leje, si rrjedhoje edhe miratim nga ARRSH per ndertim. Objekti eshte i paisur me Certificate pronesia per pasurine. Faleminderit.		
37	07.08.2025	Përshëndetje, Dua të denoncoj një krim të rëndë mjedisor që po i bëhet Lumit Erzen nga një kompani private, e cila po masakron ekosistemin e lumit dhe po shkakton dëme të paimagjinueshme për natyrën dhe komunitetin. Para disa muajsh, kam denoncuar këtë çështje pranë disa institucioneve të shtetit, të cilat	18.09.2025	I nderuar, Në vijim të ankesës suaj të fundit, lidhur me pretendimet për ndërhyrje dhe dëmtime mjedisore në lumin Erzen dhe Grykën e Sokratës, ju informojmë si më poshtë: • Për ankesën tuaj të parë, ju është kthyer një përgjigje e detajuar mbi	E plote	Nuk ka

	janë përfshirë edhe në këtë email (Ministria e Mjedisit, Agjensia e Mjedisit, Policia Bashkiake, Policia e Shtetit, Bashkia etj.), por nuk është marrë asnjë masë konkrete për të ndaluar këtë krim. Kështu, për të bërë të njohur këtë situatë të papranueshme dhe për të kërkuar veprim, po ia dërgoj këtë denoncim edhe ambientalistëve, mediave, SPAK, Prokuroria, Kryeministri dhe institucioneve të tjera përkatëse. Nëse ende nuk do të ndërmerren veprime konkrete dhe ky krim mjedisor do të vazhdojë, ky denoncim do të shkojë drejtpërdrejt në SPAK dhe Prokurorinë e Tiranës për hetim për mosveprim dhe korrupsion të inspektoreve dhe drejtoreshave. Po ashtu, ata që janë të përfshirë në		dokumentacionin që disponon subjekti Age Erzen, duke sqaruar të gjitha elementet ligjore dhe teknike në lidhje me aktivitetin e tij. • Pas paraqitjes së ankesës së dytë, u krye një riinspektim në terren nga ekipi ynë, duke filluar nga vepra e marrjes në Grykën e Sokratës (e ndërtuar para viteve '90) deri te baseni i presionit. • Nga inspektimi rezultoi se në këtë segment nuk po kryheshin punime të reja. Në terren u konstatua vetëm prania e punimeve ekzistuese, të cilat janë pasqyruar edhe më parë.		
--	--	--	--	--	--

	këtë shkelje do të denoncohen dhe për veprime korruptive. Krimi i shkaktuar nga firma hidrocentralesh "Age Erzen" (L51810011P) Që prej një viti, lumi Erzen po shkatërrohet nga mbeturinat që po hidhen aty nga kjo kompani, duke shkaktuar një dëm të madh mjedisor. Ata kanë hedhur mbeturina që janë krijuar gjatë 30 viteve të kaluara, duke shkatërruar çdo gjallesë në këtë lum. Lumi, që dikur ishte një mrekulli natyrore, është kthyer në një mocalishte të shëmtuar. Po ashtu, duke shqyrtuar fotot në Google Earth dhe duke i krahasuar me ato të vitit të fundit, është e qartë se lumi ka kaluar një ndryshim dramatik. Po ashtu, po dërgoj disa foto që kam bërë sot me datë 7.8.2025 për të		Gjithashtu, nuk u evidentuan ndërhyrje në veprën e marrjes (digë). Për më shumë transparencë, bashkëlidhur këtij emaili gjeni foto nga terreni, të cilat dokumentojnë gjendjen aktuale të zonës së inspektuar. Faleminderit.		
--	---	--	--	--	--

		krahasuar gjendjen aktuale të lumit. Veprime të jashtëligjshme nga firma dhe neglizhencë nga autoritetet Sipas informacionit që kam marrë nga banorët e Pellumbasit dhe fshatit Hekal, firma ka marrë leje për të ndërtuar një hidrocentral në afërsi të fshatit Hekal, por në fakt kanë kryer një masakër mjedisore. Ata nuk kanë leje për të kryer punime në digën e Skoranes, por po ndërhyjnë në mënyrë të jashtëligjshme, duke shkatërruar terrenin dhe hedhur mbeturina dhe llucë në lumë. E gjithë kjo ka ndodhur vetëm për të shtuar përfitimet financiare të firmës, pa pasur parasysh dëmimin e natyrës dhe shkatërrimin e florës dhe faunës. Ndërhyrja e tyre ka shkatërruar shtresën natyrore të				
--	--	---	--	--	--	--

		lumit dhe ka dëmtuar jetesën e shumë specieve. Për më tepër, ky lum dhe shpella e Pellumbasit janë atraksione të njohura turistike, të vizituara nga mijëra vizitorë çdo vit për ujin e pastër dhe natyrën e paprekur. Tani, pasi ka filluar shkatërrimi, vizitorët e paktë që mbeten janë të shqetësuar dhe të frikësuar nga gjendja e lumit. Pushteti vendor dhe inspektorate të korrumpuar E çuditshme është se si pushteti vendor dhe inspektoriatet përkatëse, të cilët kanë për detyrë të mbrojnë mjedisin, nuk kanë ndërhyrë. Ne kemi informacion të sigurve që inspektorate të ndryshme (IKMT, Ministria e Mjedisit, Bashkia, etj.) janë paguar për të lejuar vazhdimin e këtij shkatërrimi mjedisor, me				
--	--	---	--	--	--	--

		ryshfete që variojnë nga 5,000 deri në 10,000 euro. Pavarësisht se ne kemi denoncuar këtë situatë, këto institucione janë mjaftuar me një përgjigje të thjeshtë dhe të paqartë, duke pretenduar se punimet janë me leje dhe se gjithçka është në rregull. Në fakt, inspektorët që kanë shkuar në vendngjarje, nuk kanë marrë masa dhe kanë pranuar fjalë të pabaza nga kompania. Ata e kanë bërë sikur kanë inspektuar punimet dhe janë larguar, pa ndërmarrë asnjë hap për të parandaluar shkatërrimin, dhe rregulluar pjesen e tyre për vetë. Pas reshjeve të shiut, ky shok i Hidrocentralit ka kryer veprime të jashtëligjshme tek diga dhe në lumë, duke hedhur mbeturina dhe				
--	--	---	--	--	--	--

		llucë, duke shkaktuar një skandal mjedisor. Ndërkohë, në tubin dhe kanalën e tij kalon vetëm uji i pastër. Shkoni nesër, zotërinj, dhe shikojeni këtë situatë. Nëse ju përtoni të shkoni atje, apo nuk jua merr mendja, po ju them fjalët e një specialisti të ujërave që thotë se kjo ndodh sepse ata kanë kryer diçka të jashtëligjshme në digë, duke derdhur llumin dhe mbeturinat në lumë, për t'i krijuar vetes një favor të jashtëligjshëm, duke bërë një krim shumë të rëndë. Thirrje për veprim të menjëhershëm Ju lutem, ju kërkohet që të merrni veprime të menjëhershme për të ndaluar këtë shkatërrim mjedisor dhe të filloni hetimet për këtë çështje. Kjo është një ngjarje e				
--	--	--	--	--	--	--

		paprecedentë që kërkon veprime urgjente dhe të drejta. Bashkëngjitur po dërgoj disa foto për të dokumentuar ndryshimet e rëndësishme që kanë ndodhur në lumin Erzen gjatë viteve të fundit. Po ashtu, do të dërgoj edhe disa foto dhe video të situatës aktuale, duke përfshirë gjendjen e tubit dhe kanalit të ujit për hidrocentral. Ju lutem, hapni Google dhe kontrolloni historikun në vitet e kaluara. Shikoni ndryshimin e lumit gjatë viteve, krahasuar me vitin e fundit, si dhe fotot e kanioneve. Unë do t'ju dërgoj disa foto të kanioneve si ishin më parë dhe disa të tanishme, për t'i krahasuar dhe parë ndryshimet e dukshme. Po kështu po ju dërgoj dhe disa foto nga Google te diges se Skoranes.				
--	--	---	--	--	--	--

		Shikoni si ka qene siper diges ne vitet 2021,2022 dhe si eshte ne mars 2025 ku duket qarte qe ka nderhyre ne te dy anet duke devijuar lumin. Ne fotot e meparshme lumi eshte ne shtratin e tij ne njerin krah dhe ky zoteri e ka hapur ne te dyja anet dhe materialin lluce e hedh ne lume.				
38	14.08.2025	Pershendetje, Une XXXXXX, nepermjet shkreses se dates 27.05.2025, drejtuar IKMT, Gjirokaster nepermjet Postes Shqiptare me kod gjurmimi, kam kerkuar marrjen e masave ne lidhje me banesen time familjare e cila edhe pse ndodhet ne proces gjyqesor eshte bere objekt nderhyrjes ndertimore te parregullta nga pala debitore,	15.08.2025	Pershendetje, z. xxxxxx, Bashkëngjitur ju dërgojmë korrespondencën shkresore të mbajtur me IVMT – Bashkia Gjirokastër lidhur me ankesën tuaj, së bashku me kthimin e përgjigjes nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, Drejtoria Rajonale Gjirokastër. Ju falënderojmë.	E plote	Nuk ka

		nderhyrje ne objekt te cilat kane sjelle shqetesime edhe per banoret e pallatit. Ndodhur ne kushtet ku une nuk ndodhem ne ate banese dhe nuk kam nje adrese fikse per tu informuar ne lidhje me kete kerkese per marrje masash, ka vendosur ne shkrese numrin e kontaktit, por nu kam asnje pergjigje nga ana e IKMT Gjirokaster. Persa me siper, bazuar ne Ligjin "Per te drejten e informimit" i ndryshuar, kerkoj te infomrohem ne lidhje me masat e marra nga ky institucion ne lidhje me kerkesen time. Duke ju falenderuar paraprakisht,				
--	--	--	--	--	--	--

		Mbetem ne pritje te pergjigjes tuaj.				
39	14.08.2025	Unë, si banor i zonës Maqellarë, ju paraqes këtë kërkesë zyrtare në përputhje me Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” dhe Ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, lidhur me një shkelje të hapur të hapësirës publike dhe mosveprim të autoritetit vendor (IMT Dibër). Përshkrimi i situatës: Tre pallatet trekatëshe ekzistuese në Maqellarë (të vetmet në zonë) kanë hapësirat publike të rrethuara plotësisht nga	18.08.205	Përshëndetje, Drejtuar: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Dibër Për dijeni: xxxxxxxxxxxxxxxx Nga sistemi i informacionit të koordinatorit për të drejtën për informim (IKMT) ka ardhur një ankesë lidhur me mosveprim dhe zënie të hapësirës publike në zonën Maqellarë. Bashkëlidhur po ju përcjellim për kompetencë ankesa për verifikim dhe trajtim nga ana juaj. Faleminderit për bashkëpunimin.	E deleguar	Nuk ka

		disa banorë të kateve përdhese. • Është lënë vetëm hyrja për në pallat, ndërsa çdo pjesë tjetër është privatizuar në mënyrë të paligjshme, duke na privuar nga e drejta e përdorimit të hapësirës së përbashkët. • Përveç kësaj, janë bllokuar trotuaret në disa zona përreth, duke penguar lëvizjen e lirë të këmbësorëve. • Janë ndërtuar baraka dhe struktura të paligjshme, që e bëjnë pamjen e zonës të duket si në kushte mesjetare dhe jo të denja për një mjedis urban. • Aktualisht, çdo objekt që bie nga dritaret apo ballkonet duhet të merret				
--	--	--	--	--	--	--

		duke trokitur në derën e atyre që kanë rrethuar hapësirën. Veprime të mëparshme: • Kam raportuar rastin në aplikacionin “Hapësira ime publike” – asnjë reagim. • Kam bërë ankesë te IMT Dibër – asnjë masë dhe asnjë përgjigje zyrtare brenda afatit ligjor. Kërkoj nga IKMT: 1. Të kryejë verifikim në terren në adresën: Maqellarë, tre pallate trekatëshe ekzistuese.				
--	--	--	--	--	--	--

		2. Të ndërmarrë masat e nevojshme për lirim të hapësirës publike, trotuareve dhe heqjen e barakave të paligjshme. 3. Të më kthejë përgjigje me shkrim brenda afatit 30-ditor, sipas nenit 66 të Kodit të Procedurave Administrative. Kontakt për përgjigje Me respekt, Banor i zonës Maqellarë				
40	14.08.2025	Përsëndetje, Ju falenderoj për përgjigjen e shpejtë por ka disa pika të cilat nuk janë të qarta në përgjigjen tuaj.	28.08.2025	Përsëndetje, Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, ju njoftojmë se, në bazë të verifikimeve të kryera nga	E plotë	Nuk ka

		1. Për pikën e parë nuk i jeni përgjigjur kërkesës se cilat kanë qënë impiantet e inspektuara. Ju lutem na listoni HEC-et e inspektuara dhe vendndodhjen e tyre (emrin, lumin apo degën e lumit, Njësinë Administrative). Ndërsa për situatën 3.5 vjeçare, na saktësoni sa ka qënë numri i ankesave të ardhura nga përfaqësuesit e komuniteteve, sa nga AMBU, sa nga KBU, sa nga K KU? 2. Lidhur me “bllokimin e sistemit, si pasojë e riformatimit me bazën e re ligjore”, konkretisht gjykojmë se materialet ne fjalë janë edhe të arkivuara, -në arkivë osë nëpër kompjutera-. Dihet se ju ua dërgoni edhe palëve të treta, p.sh., ua dërgoni gjykatave, apo kur ua		drejtoria përkatëse, rezulton si më poshtë: Sa i përket pikës së parë të kërkesës suaj, bashkëlidhur do të gjeni listën e HEC-eve të inspektuara, ku janë pasqyruar: • Emri i HEC-it; • Vendndodhja; • Masa administrative e marrë ndaj tyre. Në lidhje me paralajmërimet, sqarojmë se ato janë vendosur në zbatim të nenit 44 të Ligjit nr. 99/2024, ku përcaktohet se: Paralajmërimi është dënimi administrativ kryesor në inspektimin e parë të trupës së inspektimit; Aplikohet për shkelje të lehta ose raste kur ligji i posaçëm nuk		
--	--	--	--	---	--	--

		përcillni subjekteve, në kuadër të procesit të njoftimit dhe të ankimit administrativ. KLSH-së po ashtu, i përcillen materialet e inspektimit me shkresë zyrtare etj. Në këto rrethana, dërgimi i listës së HEC-eve është plotësisht i mundur. Do të isha tejet mirenjohes nëse do të vihej në dispozicion informacioni i kërkuar, pa qene nevoja për të vijuar një proces ankimimi pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit. Faleminderit paraprakisht,		parashikon një dënim tjetër administrativ; Shoqërohet me urdhërimin e subjektit për korrigjimin e shkeljeve brenda një afati të caktuar; Në rastet e shkeljeve të rënda, nuk zbatohet paralajmërimi, por masa të tjera të përcaktuara me ligj. Për sa i përket situatës 3.5 vjeçare të ankesave, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe të dhënave në arkivën e institucionit, rezultoi se gjatë kësaj periudhe janë regjistruar gjithsej tre (3) ankesa të ardhura nga komunitetet dhe institucionet relevante. Faleminderit.		
--	--	---	--	--	--	--

41	15.09.2025	Drejtuar: Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit (IMT), Tiranë Lënda: Kërkesë për informacion mbi lirimimin e hapësirave publike në Tiranë Përshëndetje, sot me datë 15 shtator, në mbështetje të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ju paraqes këtë kërkesë, për informacion me karakter publik. Ju lutem të vini në dispozicion të dhëna mbi veprimtarinë e IMT lidhur me lirimimin e hapësirave publike në territorin e Bashkisë së Tiranës, konkretisht: 1. Në muajin korrik nisi aksioni për lirimimin e hapësirave publike në Tiranë, sa sipërfaqe	15.09.2025	Përshëndetje , Drejtuar: Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit (IMT), Bashkia Tiranë Për dijeni Në adresën e-mailit të koordinatorit të të drejtës për informim, IKMT, është paraqitur kërkesa nga, për informacion mbështetur në Ligjin nr. 119/2014, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”. Bashkëlidhur po Ju përcjellim për kompetencë kërkesën sipas ligjit të sipërcituar paraqitur nga për verifikim dhe trajtim nga ana Juaj. Faleminderit!	E deleguar	Nuk ka
----	------------	---	------------	--	------------	--------

		publike është liruar nga aksionet e IMT-së. 2. Cilat janë zonat/kategoritë e hapësirave publike ku është ndërhyrë më së shumti (rrugë, trotuare, lulishte, sheshe etj.)? 3. Sa objekte (kioska, ndërtime pa leje, struktura të përkohshme apo elementë të tjerë) janë hequr nga hapësirat publike gjatë kësaj periudhë? 4. A janë vendosur gjoba apo masa administrative ndaj subjekteve që kanë zënë hapësira publike në mënyrë të paligjshme? Nëse po, sa është numri i tyre dhe vlera e gjobave? 5. Çfarë ndodh me hapësirat e liruara pas ndërhyrjes së IMT-së, a kthehen menjëherë në funksion				
--	--	--	--	--	--	--

		publik dhe kush është institucioni përgjegjës për menaxhimin e tyre? 6. A ka një plan apo strategji të IMT për parandalimin e zënies së përsëritur të hapësirave publike? 7. Sa kohë pritet të zgjasë aksioni? Duke qenë se ky informacion është me interes publik, pres përgjigjen tuaj brenda afatit ligjor nga dorëzimi i kërkesës. Ju falënderoj për bashkëpunimin dhe transparencën.				
42	08.10.2025	Lënda: Kërkesë për pezullim të veprimeve dhe verifikim ligjor lidhur me prishjen e murit	10.10.2025	Përsëritet, Në dijeni: Drejtuar: Autoritetit Rrugor Shqiptar (ARRSH)	E deleguar	Nuk ka

	rrethues në pronë private në fshatin Paulesh, Peqin. E nënshkruara, banuese në fshatin Paulesh, Bashkia Peqin, ju drejtohem me këtë kërkesë për ndërhyrje dhe verifikim lidhur me një njoftim verbal që kemi marrë më datë 07.10.2025 nga punonjës në terren, për prishjen e murit rrethues të banesës sonë që ndodhet në anë të rrugës nacionale që kalon përmes fshatit Paulesh. Faktet dhe rrethanat: - Muri rrethues është ndërtuar brenda kufijve të pronës private të legalizuar, e cila nuk është objekt as projekti shpronësimi dhe as ndërtimi publik. - Nuk është bërë asnjë njoftim zyrtar me shkrim, as nga ARRSH, as nga Drejtoria Rajonale e Rrugëve Elbasan, as nga ndonjë institucion tjetër		Në adresën zyrtare të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT) është paraqitur, datë 08.10.2025. Bashkëlidhur po ju përcjellim kërkesën e paraqitur nga Lutemi në trajtimin e kërkesës së sipërcituar. Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,		
--	---	--	--	--	--

		publik. - Nuk është paraqitur asnjë akt ekspertimi, vendim për shpronësim apo vlerësim dëmi, sipas kërkesave të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik”. - Prishja e paralajmëruar do të cënonte rëndë pronën tonë dhe do të përbënte shkelje të nenit 41 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (e drejta e pronës private). Në bazë të ligjit dhe për rrethana të mësipërme, kërkoj: 1. Të verifikohet ligjshmëria e veprimeve të paralajmëruara për prishjen e murit rrethues. 2. Të pezullohen menjëherë çdo ndërhyrje ose veprim në terren deri në përfundimin e verifikimeve ligjore. 3. Të më vihet në dispozicion çdo				
--	--	---	--	--	--	--

		dokument zyrtar (projekt, urdhër, vendim apo plan shpronësimi) që lidhet me këtë segment rrugor. 4. Të mbahet parasysh se çdo veprim pa procedurë shpronësimi përbën shkelje administrative dhe penale, për të cilën do të ndiqen rrugët ligjore përkatëse.				
43	09.10.2025	Në kuadër të transparencës publike, duke u bazuar tek ligji Nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, i ndryshuar, kërkon si informacion: 1.Listën e plotë të subjekteve të gjobitura me niptin përkatës nga Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit për shkarkimet e paligjshme ose ndotjen e shkaktuar nga këto	23.10.2025	Përhëndetje, Në përgjigje të kërkesës suaj për dhënien e listës së plotë të subjekteve të gjobitura me NIPT-in përkatës nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT) për shkarkime të paligjshme ose ndotje të shkaktuar në lumin Shkumbin, ju bëjmë me dije sa vijon: Drejtoria e Inspektimit të Mjedisit dhe Ujërave është ngritur dhe ka filluar funksionimin si pjesë e strukturës së Inspektoratit	E plote	Nuk ka

		subjekte në lumin Shkumbin për vitin 2019. 2. Listën e plotë të subjekteve të gjobitura me niptin përkatës nga Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit për shkarkimet e paligjshme ose ndotjen e shkaktuar nga këto subjekte në lumin Shkumbin për vitin 2020. 3. Listën e plotë të subjekteve të gjobitura me niptin përkatës nga Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit për shkarkimet e paligjshme ose ndotjen e shkaktuar nga këto subjekte në lumin Shkumbin për vitin 2021. 4. Listën e plotë të subjekteve të gjobitura me niptin përkatës nga Inspektoriati Kombëtar i		Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT) në periudhën shtator–tetor të vitit 2020. Për rrjedhojë, IKMT nuk disponon të dhëna lidhur me subjektet e gjobitura apo masat administrative të marra për ndotje të shkaktuara para këtij viti. Për informacion për periudhën para vitit 2020, ju rekomandojmë të drejtoheni pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM). Bashkëlidhur këtij komunikimi, ju përcjellim listën e subjekteve të inspektuara, ndaj të cilave janë marrë masa administrative me gjobë nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, për secilin prej viteve të kërkuara. Në lidhje me kërkesën tuaj për NIPT-in e subjekteve të sipërpërmendura, ju informojmë se kjo e dhënë mbrohet nga Ligji nr.	
--	--	---	--	---	--

		Mbrojtjes së Territorit për shkarkimet e paligjshme ose ndotjen e shkaktuar nga këto subjekte në lumin Shkumbin për vitin 2022. 5. Listën e plotë të subjekteve të gjobitura me niptin përkatës nga Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit për shkarkimet e paligjshme ose ndotjen e shkaktuar nga këto subjekte në lumin Shkumbin për vitin 2023. 6. Listën e plotë të subjekteve të gjobitura me niptin përkatës nga Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit për shkarkimet e paligjshme ose ndotjen e shkaktuar nga këto subjekte në lumin Shkumbin për vitin 2024.		124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Faleminderit.		
--	--	--	--	--	--	--

44	14.10.2025	Përschendetje, Bashkëlidhur do të gjeni Kërkesën për informacion si dhe shkresat referuese. Në pritje të një përgjigjeje sa më të shpejtë nga ana juaj, Faleminderit për bashkëpunimin.	24.10.2025	Përschendetje, Në vijim të kërkesës për informacion në lidhje me ankesën e paraqitur, ju bëjmë me dije sa më poshtë: Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT), në zbatim të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, pas marrjes së ankesës, ka dërguar për kompetencë verifikimin dhe trajtimin e rastit pranë Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Kavajë (IMT Bashkia Kavajë). Bashkëlidhur do të gjeni shkresën e dërguar për trajtim. Faleminderit.	E plote	Nuk ka
45	15.10.2025	Pershendetje	20.10.2025	Përschendetje,	E deleguar	Nuk ka

		Lutem gjeni bashkelidhur ne kete email kerkesen zyrtare. Kerkesa eshte shoqeruar me materialet relevante perkatese. Gjithashtu, bejme me dije se nga nje kopje origjinale te kerkeses tone eshte percjelle me rruge postare prane institucioneve tuaja si edhe prane Prokurorise prane Gjykates se Shkalles se Pare Durres. Falemindert, Pune te mbare!		Drejtuar: Bashkia Kavajë Për dijeni: xxxxxxxxxxxxxxxx Në adresën e e-mailit të koordinatorit të të drejtës për informim të IKMT, është paraqitur një kërkesë xxxxxxxxxxxxxxxx në zonën e Qerretit, Kavajë. Bashkëlidhur po ju përcjellim kërkesën zyrtare dhe materialet përkatëse për kompetencë dhe trajtim nga ana Juaj. Faleminderit!	Bashkise Kavaje	
46	23.10.2025	Përsëhëdetje, Dua të bëj një denoncim për një ndërtim që po zhvillohet	23.10.2025	Përsëhëdetje , Drejtuar: Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit, Bashkisë Diber	E deleguar	Nuk ka

		aktualisht në fshatin Selishtë, në qarkun e Dibrës. Sipas informacioneve të mia, ndërtimi po kryhet pa leje dhe në një truall që është objekt i një çështjeje gjyqësore. Forcat e policisë kanë qenë më parë në vendngjarje pas një denoncimi të mëparshëm, por punimet kanë rifilluar menjëherë pas largimit të tyre dhe po vazhdojnë edhe në këto momente. Ju lutem të ndërmerren masat e nevojshme për ndalimin e menjëhershëm të punimeve dhe verifikimin e situatës në terren.		Për dijeni: Në adresën e-mailit të koordinatorit të të drejtës për informim, IKMT, është paraqitur kërkesa/ankesa. Bashkëlidhur po Ju përcjellim për kompetencë kërkesën e paraqitur nga për verifikim dhe trajtim nga ana Juaj.		
47	29.10.2025	1. Sa inspektive janë kryer në minierën e Bulqizës gjatë 5 viteve të fundit?	11.11.2025	Përsëndetje, Në vijim të kërkesës suaj për informacion lidhur me inspektimet	E plote	Nuk ka

		2. Sa kompani janë ndëshkuar për hedhje të paligjshme të mbetjeve minerare apo ndotje të ujërave? 3. A ka pasur raste pezullimi aktiviteti për ndotje? Nëse po, cilat kompani janë përfshirë?		e kryera nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT) në minierën e Bulqizës gjatë pesë viteve të fundit, ju bëjmë me dije sa vijon: 1. Lidhur me numrin e inspektimeve të kryera në minierën e Bulqizës gjatë pesë viteve të fundit fillimisht ju bëjmë me dije se Drejtoria e Inspektimit të Mjedisit dhe Ujërave është ngritur dhe ka filluar funksionimin si pjesë e strukturës së Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT) në periudhën shtator–tetor 2020. Gjatë periudhës së kërkuar IKMT ka kryer 12 inspektime në subjektet që		
--	--	---	--	--	--	--

				ushtrojnë aktivitet në zonën e minierës së Bulqizës. 2. Lidhur me masat administrative për hedhje të paligjshme të mbetjeve minerare apo ndotje të ujërave gjatë inspektimeve të kryera nga Drejtoria e Inspektimit të Mjedisit dhe Ujërave pranë IKMT-së, është marrë masë administrative ndaj 8 subjekteve, në përputhje me legjislacionin mjedisor në fuqi. 3. Lidhur me pezullimin e aktiviteteve për shkak të ndotjes, sipas të dhënave të evidentuara gjatë periudhës së pesë viteve të fundit nuk janë marrë masa pezullimi të aktivitetit ndaj subjekteve që ushtrojnë veprimtari në		
--	--	--	--	---	--	--

				zonën e minierës së Bulqizës për shkak të ndotjes mjedisore. Faleminderit.		
48	05.11.2025	Të nderuar, Në zonën kadastrale nr. 1462 (Dellenjë, Bashkia Vlorë), pjesë e territorit të PDZRK Vjosë–Nartë dhe e Peizazhit të Mbrojtur “Vjosë–Nartë” (kategoria e V-të sipas Ligjit nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”), është ndërtuar një objekt që ndodhet jashtë vijës së verdhë të zhvillimit, siç përcaktohet në dokumentin zyrtar të planit. Objekti në fjalë ka qenë magazinë dhe aktualisht po transformohet në njësi banimi me qëllim	15.01.2025	I nderuar, Ju informojmë se ankesa juaj është përcjellë për trajtim pranë IMT së Bashkisë Vlorë, nga Drejtoria Rajonale. Bashkëlidhur gjeni shkresën përcjellëse të DRIMT Vlorë drejtuar IMT Vlorë. Faleminderit	E plote	Nuk ka

		përdorimin si hotel, duke ndryshuar përdorimin e tokës pa miratim nga organet kompetente dhe duke cënuar ekuilibrin mjedisor të zonës së mbrojtur. Në bashkëngjitje po dërgoj dokumentim vizual të situatës: Pamje nga Geoportali ASIG (viti 2015) – ku objekti nuk ekziston; Pamje nga Google Maps (viti 2025) – ku objekti shihet si magazinë; Foto aktuale nga terreni (2025) – ku duken qartë punimet e kthimit të magazinës në njësi banimi për përdorim hotelier. Ky zhvillim përbën shkelje të neneve 20 dhe 32 të Ligjit nr. 81/2017 dhe të VKM nr. 686, datë 22.11.2017, pasi ndërtimi				
--	--	---	--	--	--	--

		dhe ndryshimi i destinacionit të objekteve nuk lejohet jashtë vijës së verdhë të zhvillimit, përveç rasteve të infrastrukturës publike. Kërkoj verifikimin e menjëhershëm të këtij ndërtimi dhe marrjen e masave administrative e inspektuese nga strukturat përkatëse, në përputhje me ligjin në fuqi dhe PDZRK-në e miratuar për zonën.				
49	25.11.2025	Ankesë e ardhur nga Inspektorati i Përgjithshëm I nënshkruari XXXXXXXXX, Parashtroj: Pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, është në shqyrtim çështja civile me palë ndërgjyqëse dhe objekt:	26.11.2025	I nderuar, Në vijim të ankesës tuaj të datës 09.09.2025, të depozituar në adresën zyrtare elektronike të Inspektoratit të Përgjithshëm, ju bëjmë me dije se materiali është deleguar në Insekotatin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit. Pas verifikimit nga ana jonë, ju njoftojmë se komunikimi i fundit	E plote	Nuk ka

		Paditës: XXXXXXXXX. I Paditur: XXXXXXXXX. Objekti: Njohje Pronar. Kjo pasuri në gjykim ndodhet brenda zonës së Shërbimeve Qeveritare, Plazh, Durrës, në adresën: Pala tjetër, XXXXXXXXX, me të tretë, ka kryer ndërtim dhe shtesa pa leje, ndërkohë që unë kam depozituar një kërkesë për sigurim padie pranë Gjykatës së Apelit Tiranë për të ndaluar çdo ndërhyrje deri në vendimin përfundimtar. Megjithatë: 1. Pala ka vazhduar punimet duke shkelur ligjin dhe duke injoruar kërkesën për sigurim padie.	zyrtar me strukturat përkatëse të Bashkisë Durrës është kryer në datën 13.11.2025, dhe aktualisht jemi në pritje të përgjigjes zyrtare nga ana e tyre lidhur me verifikimet dhe masat administrative që do të ndërmerren sipas ligjit. Ju falënderojmë		
--	--	--	--	--	--

		2. Ka dyshime se disa zyrtarë shtetërorë, mund të kenë toleruar ose lejuar veprimet për motive të fshehta, duke përfshirë përfitime personale ose favore ndaj pronarit. 3. Veprimet e vazhduara mund të fshijnë prova dhe të pengojnë drejtësinë, duke e bërë hetimin penal të vështirë. Ky veprim përbën një shkelje të qartë të ligjit dhe të normave penale të sipërpërmendura. Kam kërkuar nga XXXXXXXXXX: 1. Të regjistrohet procedimi penal dhe të nisë hetimi i menjëhershëm për veprat e sipërpërmendura.				
--	--	---	--	--	--	--

		2. Të kryhet verifikim i menjëhershëm në terren dhe të ndalohet çdo punim i mëtejshëm. 3. Të sekuestrohen dokumentet, lejet, kontratat dhe çdo provë tjetër që mund të përdoret në hetim. 4. Të procedohen penalisht pronari i objektit, çdo person që ka kryer ndërtimin, si dhe çdo zyrtar shtetëror që mund të ketë lejuar, toleruar ose ndihmuar këto veprime në mënyrë të paligjshme. 5. Të shqyrtohet mundësia e ekzistencës së lidhjeve të paligjshme (XXXXXXXX) midis pronarit dhe zyrtarëve.				
--	--	---	--	--	--	--

50	25.11.2025	Përshtëndetje, Bashkëlidhur do të gjeni kërkesën për informacion dhe proceverbalin. Në pritje të një përgjigjeje sa më të shpejtë nga ana juaj, Faleminderit për bashkëpunimin.	03.12.2025	Përshtëndetje, Në vijim të kërkesës suaj për informacion në lidhje me inspektimin e kryer nga IKMT, ju bëjmë me dije si më poshtë: Bashkëlidhur po ju vendosim Vendimin Përfundimtar të inspektimit nga IKMT, datë 02.06.2025, si dhe Vendimin e Komisionit të Ankimimit, datë 16.07.2025, për inspektimin e kryer në vendgrumbullimin e paligjshëm në Kodër-Dollak Fushë Krujë, Bashkia Krujë, Qarku Durrës. Faleminderit.	E plote	
51	25.11.2025	Përshtëndetje, Në zbatim të Ligjit nr.99/2024 , "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" si dhe urdhërit Nr.	26.11.2025	Në dijeni: XXXXX Drejtuar: Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit, Bashkisë Vlorë	E deleguar IMT Vlore (26.11.2025)	Nuk ka

		144, datë 02.09.2025 , ju bëjmë me dije se, Ankesat e ardhura në adresën zyrtare elektronike të Inspektoratit të Përgjithshëm janë këqyrrur dhe administruar me vonesë për arsye të Ri-Strukturimit të Inspektoratit të Përgjithshëm Për këtë arsye më poshtë gjeni komunikimin elektronik të dërguar nga ana e subjektit, Ju faleminderit dhe punë të mbarë,		Në adresën e e-mailit zyrtar të IKMT-se është paraqitur ankesa nga xxxxxx, deleguar nga Inspektoratit të Përgjithshëm datë 25.11.2025. Bashkëlidhur po ju përcjellim ankesën e paraqitur. Lutemi në trajtimin e ankesës së sipërcituar, në përputhje me kompetencat dhe legjislacionin për mbrojtjen e territorit. Duke ju falenderuar		
52	08.12.2025	Unë jam një banor i zonës së Bashkisë Kamëz dhe paraqes këtë ankesë plotësisht në mënyrë anonime, për të mbrojtur privatësinë time dhe të komunitetit.	15.12.2025	Përsëendetje, Në kthim të përgjigjes së kërkesës suaj, në lidhje me antenën celulare të vendosur në lagjen nr. 7, Bathore, Kamëz, rruga “Lekbibaj”, ju bëjmë me dije se kërkesa juaj është deleguar nga ana jonë pranë Institutit të Shëndetit Publik	E plote	Nuk ka

		Në lagjen numer 7 Bathore, Kamez, rruga Lekbibaj dikur por e emeruar se fundmi rruga Dine Doda shtepia para nje ndertimi te nje pallati te ri qe po behet është vendosur një antene celulare, e cila ndodhet në afërsi të menjëhershme të banesave të banuara. Edhe pse antena mund të ketë leje zyrtare, ajo përbën dyshimin më të madh të komunitetit si burim i problemeve serioze shëndetësore që janë shfaqur vitet e fundit. Deri tani, shume banorë të lagjes janë diagnostikuar me sëmundje të rënda, përfshirë sëmundje kanceroze. Të gjithë banorët e prekur dhe komuniteti ynë janë të bindur se antena mund të jetë shkaktarja, dhe ky dyshim është i mbështetur nga fakti që rastet shëndetësore janë shfaqur vetëm pas vendosjes së antenës. Dua të theksoj se nuk po deklarojmë si fakt ligjor lidhjen shkak-pasojë — prandaj kërkojmë që këtë ta verifikojnë	(ISHP), si dhe pranë Zyrës së Mbrojtjes nga Rrezatimet. Nga këto institucione është kthyer përgjigje, e cila gjendet e bashkëlidhur në këtë email. Për çdo ankesë apo kërkesë të mëtejshme në lidhje me çështjen e sipërpërmendur, ju lutemi t'i drejtoheni drejtpërdrejt Institutit të Shëndetit Publik (ISHP). Faleminderit.		
--	--	--	---	--	--

		institucionet përmes matjeve dhe analizave të specializuara. Për këtë çështje është dorëzuar edhe një ankesë e mëparshme nga banorët, por deri tani nuk kemi marrë një përgjigje apo një raport matjesh. Ne kërkojmë urgjentisht nga institucioni juaj: 1. Kryerjen e matjeve të detajuara të rrezatimit elektromagnetik rreth antenës. 2. Verifikimin e të gjitha lejeve, distancave dhe kriterëve teknike që antena duhet të plotësojë. 3. Kërkojmë që ISHP të iniciojë një vlerësim epidemiologjik të zonës, për të analizuar rritjen e rasteve të sëmundjeve të rënda. 4. Transparencë të plotë me komunitetin dhe publikimin e rezultateve. Ju lutem trajtojeni këtë çështje me seriozitetin maksimal, pasi komuniteti ynë po jeton në				
--	--	--	--	--	--	--

		pasiguri të plotë dhe me frikë për shëndetin e familjeve tona. Me respekt,				
53	12.12.2025	E nderuar, · Sa është numri i ndërtimeve pa leje të konstatuara për periudhën Janar 2024- Dhjetor 2025? (të ndara sipas qyteteve) · Çfarë masash janë marrë në lidhje me ndërtimet pa leje të konstatuara për këtë periudhë?	16.12.2025	Përsëndetje, Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion në lidhje me numrin e ndërtimeve pa leje të konstatuara për periudhën Janar 2024 – Dhjetor 2025 (të ndara sipas qyteteve), ju informojmë se, në përputhje me Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, përgjegjësia për kontrollin e territorit, konstatimin e ndërtimeve pa leje dhe marrjen e masave administrative në nivelin e njësive vendore i përket Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit (IMT) pranë bashkive përkatëse. Faleminderit.	E plote	Nuk ka

54	12.12.2025	Në trajtim të ankesës time me numer gjurmimi MB-2025-6245217-BI, nga ana e IKMT më është kthyer përgjigje në platformen qeveritare e-albania me shkresën e datës, 09.12.2025 ku bashkangjitur më është vënë në dijeni dhe shkresa nr. 20211 prot. datë, 25.11.2025 e IVMT pranë Bashkisë Lezhë me lëndë “Dërgim Informacioni” drejtuar IKMT ku bashkangjitur ndër të tjera IKMT-së i është vënë në dispozicion dokumentacioni “Relacionin e mbajtur nga Ing i Drejtorisë së Aseteve dhe Kadastrës, në prani të inspektorëve të Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit”. Për sa më sipër ne zbatim dhe të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” kërkoj të dhëna të regjistruara në çfarëdo lloji forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik nga institucioni i Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit në lidhje me, të mëveje në dispozicion në formë elektronike dokumentacionin si: Relacionin e mbajtur nga Ing i Drejtorisë së Aseteve dhe Kadastrës, në prani	15.12.2025	Përsëndetje, Në vijim të kërkesës suaj, me të cilën kërkoni vënien në dispozicion të të dhënave të regjistruara në çfarëdo lloji forme dhe formati, të krijuara gjatë ushtrimit të funksionit publik, konkretisht dokumentacionin në formë elektronike, si: relacionin e mbajtur nga inxhinieri i Drejtorisë së Aseteve dhe Kadastrës në prani të inspektorëve të Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit, ju bëjmë me dije se vijon: Relacioni i sipërpërmendur, si dhe çdo dokumentacion tjetër shoqërues, është mbajtur dhe administruar nga Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit (IMT) pranë Bashkisë Lezhë. Për këtë arsye, për marrjen e dokumentacionit të kërkuar, duhet t’i drejtoheni institucionit përkatës që e ka hartuar. Faleminderit.	E plote	Nuk ka
----	------------	--	------------	--	---------	--------

		të inspektorëve të Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit. Duke ju falenderuar, mbetem ne pritje te nje pergjigjeje nga ana e institucionit tuaj				
55	15.12.2025	Sa është numri dhe vlere e gjobave të vendosura nga institucioni juaj për periudhat: Janar-Maj 2024 Janar-Maj 2025	23.12.2025	Përsëndetje, Në bazë të kërkesës suaj për informacion në lidhje me gjobat për periudhat janar–maj 2024 dhe janar–maj 2025, ju bëjmë me dije: Sa i përket periudhës janar–maj 2024, sqarojmë se informacioni është dhënë më parë nga ana e institucionit tonë. Për sa i përket informacioneve për gjobat e vendosura për periudhën janar–maj 2025, ju përcjellim të dhënat përkatëse. Faleminderit.	E plote	Nuk ka
56	31.12.2025	Që me komunikimin e datës 16.04.2025, ora 1:07 PM, të IKMT-së, ku më është komunikuar se nuk mund të më mundësohet kopje e shkresës me nr. 38/4 prot., datë 27.02.2025, të DRIKMT Lezhë, si dhe kopje të procesverbalit nr. 02, datë 26.02.2025, “Për konstatimin e kundërvajtjes”, për arsyen	07.11.2026	Përsëndetje, Në vijim të kërkesës suaj për informacion ju bëjmë me dije se referuar ligjit Nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” dhe të ligjit Nr. 9887/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, informacioni i kërkuar nga ana juaj nuk mund t’ju vihet në dispozicion pasi aktet përmbajnë të	Refuzuar	Nuk ka

		se procedura në fjalë është ende në shqyrtim dhe ndaj nuk mund të bëhen publikime deri në përfundimin e procesit, shprehem se IKMT, me kthimin e përgjigjes së datës 09.12.2025 të ankesës time me numër gjurmimi MB-2025-6245217-BI, më ka komunikuar qëndrimin e mbajtur me shkresën nr. 20211 prot., datë 25.11.2025, të IVMT pranë Bashkisë Lezhë. Në vlerësimin tim, nuk ka më argumente nga ana e IKMT-së për trajtimin e ankesës time dhe, në këto kushte, procesi ka të dhëna që është përfunduar. Për sa më sipër, në zbatim të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, kërkoj të dhëna të regjistruara në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik nga institucioni i Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, konkretisht: të më vihet në dispozicion një kopje e shkresës me nr. 38/4 prot., datë 27.02.2025, të Drejtorisë Rajonale të IKMT	dhëna të cilat i përkasin një subjekti tjetër. Faleminderit,		
--	--	---	--	--	--

		Lezhë, si dhe një kopje e procesverbalit nr. 02, datë 26.02.2025, me nr. serie 00001802, “Për konstatimin e kundërvajtjes”. Duke ju falënderuar, mbetem në pritje të një përgjigjeje nga ana e institucionit tuaj.				
--	--	--	--	--	--	--

Shënim:

¹ Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve

² Data e regjistrimit të kërkesave

³ Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁴ Data e kthimit të përgjigjes

⁵ Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁶ Përgjigja jepet E plotë/E kufizuar/E refuzuar/E deleguar

⁷ Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuara nga autoriteti publik.